

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj nxënësve në familje

Ismet Potera, Osman Buleshkaj, Bekim Morina, Skender
Mekolli, Sahare Reçica-Havolli, Luljeta Shala

Fëmijë
Familje
Ndjenjë e frikës
Ikje nga mësimi
Rënie e suksesit
Paragjykim
Përqeshje
Mbrojtje
Tentim vetëvrasje
Dhunë ndaj tjetrit
Abuzim me substanca
Ikje nga realiteti . . .



Instituti Pedagogjik i Kosovës

Ismet Potera, Osman Buleshkaj, Bekim Morina,
Skender Mekolli, Sahare Reçica-Havolli, Luljeta Shala

Shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj nxënësve në familje

Prishtinë, 2023

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Recensentë:

Këshilli Shkencor i IPK-së

Autorë:

Ismet Potera, Osman Buleshkaj, Bekim Morina, Skender Mekolli, Sahare Reçica-Havolli & Luljeta Shala

Konsulente:

Azize Sekiraça-Heta, MASHTI

Redaktor gjuhësor:

Bekim Morina

Radhitja kompjuterike:

Skender Mekolli

Ky botim u realizua në bazë të objektivit të PSAK/MASHT, ndërsa u financua nga buxheti i Institutit Pedagogjik.

Ismet Potera, Osman Buleshkaj, Bekim Morina,
Skender Mekolli, Sahare Reçica-Havolli, Luljeta Shala

Shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj nxënësve në familje

Tabela e përmbajtjes

<i>Abstrakt</i>	7
<i>Abstract</i>	8
1. <i>Përmbledhje e përgjithshme</i>	9
2. <i>Executive summary</i>	14
3. <i>Hyrje</i>	19
4. <i>Konteksti i problemit</i>	22
5. <i>Shqyrtimi i politikave dhe literaturës</i>	25
5.1. <i>Shqyrtimi i politikave nacionale</i>	25
5.2. <i>Konventa e Stambollit për mbrojtjen nga elementet e dhunës</i>	27
5.3. <i>Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë</i>	28
5.4. <i>Shqyrtimi i literaturës</i>	30
5.5. <i>Konceptet kryesore të dukurisë së dhunës ndaj fëmijës</i>	34
6. <i>Qëllimi i hulumtimit</i>	37
7. <i>Rëndësia e hulumtimit</i>	37
8. <i>Pyetjet hulumtuese</i>	38
9. <i>Metoda</i>	38
10. <i>Mostra</i>	39
11. <i>Procedurat e mbledhjes dhe përpunimi i të dhënave</i>	40
12. <i>Rezultatet e hulumtimit</i>	41
12.1. <i>Të dhënat nga institucionet përgjegjëse</i>	41
12.2. <i>Institucioni i Avokatit të Popullit</i>	42
12.3. <i>Policia e Kosovës</i>	43
12.4. <i>Qendra për Punë Sociale</i>	44
13. <i>Të dhënat nga nxënësit</i>	45
13.1. <i>Gjetjet kryesore nga rrëfimet e nxënësve</i>	47
13.1.1. <i>Dhuna nga bashkëmoshatarët dhe sjelljet asociale të nxënësve</i>	48
13.1.2. <i>Suksesi në shkollë dhe ndikimi i mësimdhënësve</i>	51

13.1.3. Marrëdhëniet jo të mira ndërmjet prindërve.....	56
13.1.4. Sjelljet abuzive si pasojë e traditës dhe gjendjes ekonomike	59
13.1.5. Abuzimi me alkool nga prindi (babai)	63
13.2. Gjetjet kryesore nga grupet e fokusit.....	67
14. Diskutimi	70
14.1. Faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në prezencën e dhunës në familje	71
14.2. Pasojat e dhunës në familje, të adresuara nga nxënësit.....	75
14.3. Mendimet e nxënësve për ndikimin e dhunës në shëndetin mendor	75
14.4. Ndikimi i dhunës në familje në shëndetin mendor të fëmijëve	76
14.5. Shkaqet dhe pasojat e dhunës – konceptet kryesore	79
15. Përfundimet	84
16. Rekomandimet.....	86
17. Kufizimet e hulumtimit.....	88
18. Burimet	89

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte vërja në pah e prezencës së dhunës në familje ndaj fëmijëve në rastet kur fëmijët ishin objekt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhunës.

Për grumbullimin e të dhënave për prezencën e dhunës ndaj fëmijëve në familje u zbatua qasja cilësore: analizë e raporteve të mekanizmave përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve; intervista me personat përgjegjës të këtyre mekanizmave; analizë e politikave ligjore për nivelin dhe cilësinë e adresimit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në familje; mbledhje dhe analiza e rrëfimeve të nxënës si dhe organizimi i diskutimeve me fokus-grupe të nxënësve.

Rezultatet e hulumtimit ndriçuan disa nga aspektet e dhunës në familje, sidomos perceptimi i dhunës nga ana e tyre është shumë domethënëse. Lidhur me shkaqet/faktorët e dhunës dhe rrjedhojat nga ajo për fëmijët, mendimet e nxënësve janë të përafërta me rezultatet e hulumtimeve shkencore të kësaj fushe. Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në ofrimin e orientimit, në adresimin e drejtë të të drejtave të fëmijëve, parandalimin e dhunës në familje, si dhe përmirësimin e të drejtave të fëmijëve kosovarë.

Për politikëbërësit dhe mekanizmat e tjerë do të hartohet dhe do të publikohet një raport me gjetjet dhe rekomandimet për secilin mekanizëm, si dhe palët e tjera të interesit.

Fjalët çelës: *adresimi i dhunës, dhuna ndaj fëmijëve në familje, faktorë e dhunës, pasojat nga dhuna, mbrojtja nga dhuna, përjetimi i dhunës, shëndeti mendor.*

Abstract

The purpose of this research was to shed light on the presence of family violence against children in situations where children were the direct or indirect object of violence.

For the collection of data on the presence of violence against children in the family, the qualitative approach was applied: analysis of the reports of the mechanisms responsible for the protection of children; interviews with the responsible persons of these mechanisms; analysis of legal policies for the level and quality of addressing the protection of children from domestic violence; collection and analysis of students' narratives as well as organization of discussions with focus groups of students.

The results of the research illuminated some of the aspects of domestic violence, especially the perception of violence on their part is very significant. Regarding the causes/factors of violence and its consequences for children, the students' opinions are close to the results of scientific research in this field. The importance of this research lies in the provision of guidance in the correct addressing of children's rights, the prevention of domestic violence and the improvement of the rights of Kosovar children.

For policy makers and other mechanisms, a report will be drawn up and published with findings and recommendations for each mechanism as well as other stakeholders.

Keywords: *addressing violence, factors of violence, violence against children in the family, consequences of violence, protection from violence, experiencing violence, mental health.*

1. Përmbledhje e përgjithshme

Me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Instituti Pedagogjik i Kosovës ka realizuar hulumtimin “Shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj nxënësve në familje”. Dukuria e dhunës njeri-njeri nuk është e panjohur. Dhuna në familje mbetet një ndër format më të përhapura të dhunës, të ushtruar në mbarë botën.

Mekanizmat e ndërtuar kundër dhunës, në Kosovë, kryesisht merren me viktimën dhe dhunuesin. Parandalimi dhe identifikimi janë dy momente shumë të rëndësishme në trajtimin e fenomenit të dhunës në familje dhe dhunës. Për këtë arsye, institucionet relevante dhe ministritë e linjës në Kosovë kanë parashikuar veprime dhe masa të lidhura me edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë, për të mos e toleruar dhunën në familje, si dhe dhunën ndaj grave e fëmijëve. Në këtë aspekt, ky studim thekson nevojën për koordinim efektiv ndërinstytucional për të mundur planifikimin e burimeve, ofrimin e shërbimeve, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Objektiv i veçantë i hulumtimit ishin nxënësit e shkollave. Shkolla, si një mekanizëm i veçantë dhe mjaft i rëndësishëm, si institucion i organizuar dhe i strukturuar, me mision e programe të veçanta për formimin e qytetarit të ri, luan një rol të rëndësishëm shoqëror në rrethin ku funksionon dhe zhvillon veprimtarinë arsimore. Për ta pasqyruar më mirë çështjen e prezencës ose jo të aspekteve të dhunës ndaj nxënësve në familje, objekt studimi ishin edhe raportet dhe statistikat e institucioneve/mekanismave përgjegjës për parandalimin dhe adresimin e akteve të dhunës dhe të mbrojtjes së fëmijëve nga çfarëdo dhune.

Qasja për identifikimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në familje, qoftë si objekt i dhunës apo pjesë pasive e dhunës, “vëzhgues”, u zhvillua në dy aspekte kryesore të këtij hulumtimi. E para, analiza e politikave dhe raporteve të mekанизmave kryesorë për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. E dyta, përfshirja rrëfimeve të nxënësve, si dhe diskutimi në fokus-grupe për të mbledhur mendimet lidhur me prezencën e dhunës ndaj tyre në familje, të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Qëllimi i ishte vërja në pah e prezencës së

dhunës në familje ndaj fëmijëve në rastet kur fëmijët ishin objekt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhunës, si dhe paraqitja e politikave aktuale në raport me format e trajtimit të rasteve të dhunës në familje.

Hulumtimi u trajtua përmes 5 pyetjeve kryesore:

- 1. A ushtrohet dhunë në familje ndaj nxënësve? Cili lloj i dhunës, nëse ka, është më i shpeshti?*
- 2. Si e perceptojnë nxënësit dhunën ndaj tyre ose shokëve/shoqeve të tyre në familje?*
- 3. Si e përjetojnë nxënësit dhunën fizike dhe verbale ndaj tyre në familje?*
- 4. Cilat janë shkaqet dhe pasojat e prezencës së dhunës për fëmijët, sipas perceptimit të nxënësve?*
- 5. Cili është roli i mekanizmave kundër dhunës për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna?*

Qasja cilësore është përdorur për grumbullimin dhe analizën e të dhënave relevante. Hulumtimi kryesisht mbështetet në rrëfimet e nxënësve për aspektet e dhunës në familje. Rrëfimet me shkrim dhe fokus-grupet me nxënës u përdorën për mbledhjen e të dhënave. Ndërsa analiza e politikave dhe dokumentacionit relevant, ishte pjesë e analizës cilësore të të dhënave. Pjesë e mostrës ishin nxënësit (N= 181), shërbimet në Qendrat Sociale për Mbrojtjen e Fëmijëve (N= 4), zyrtarët policorë (N= 3) përgjegjës për adresimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe përfaqësues të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve, si zyrtarë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Mostrën e nxënësve e përbëjnë nxënësit nga 12 shkolla të qytetit dhe të fshatit, nga klasat VI, VII, VIII dhe IX.

Përveç shqyrtimit të dokumenteve zyrtare dhe hulumtimit në terren me nxënës, u intervistuan zyrtarë të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, si: Zyra e Avokatit të Popullit, Policia e Kosovës, dhe Qendrat për Punë Sociale. Këto institucione mbledhin të dhëna/raporte për rastet e

dhunës së përgjithshme në familje, por në mënyrë specifike për përjetimin e fëmijës si subjekt i dhunës ose i pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës ndaj të tjerëve. Raportet e tyre dëshmojnë se dukuria e dhunës në familje është shumë e shprehur në shoqërinë kosovare. Rritja e angazhimit institucional për të trajtuar dhunën në familje, shpërndarja adekuate e burimeve, përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve, rritja e trajnimit profesional për reagim të përgjithshëm ndaj dhunës në familje, zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit për viktimat, mbështetja psikologjike për viktimat e dhunës dhe rehabilitimi i autorëve përmes programeve të ndryshme, janë disa nga veprimet e planifikuara nga institucionet e intervistuar.

Qëndrimet dhe mendimet e nxënësve lidhur me dukurinë e dhunës në familje ndaj nxënësve, janë grumbulluar në dy forma:

1. Përmes përgjigjes me shkrim në pyetjen: A mund ta përshkruani ndonjë rast që dini për dhunën ndaj shokut/qes që i ka ndodhur në familje ndaj tij/saj?
2. Diskutimi në grupe fokusi lidhur me shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje.

Pyetja u drejtua kësisoj për t'i ikur përvojës personale të nxënësve, nëse ndaj tij/saj është ushtruar dhunë ose ka qenë i pranishëm në rastet kur është ushtruar dhuna ndaj personave të tjerë. Ndërsa diskutimi në grupe fokusi rezultoi me identifikimin e shkaqeve dhe pasojave sipas perspektivës së nxënësve.

Të dhënat e mbledhura mbështeten në rrëfimet individuale të nxënësve lidhur me rastet e dhunës në familje, qoftë drejtpërdrejt ndaj tyre ose si pjesëmarrës pasivë. Dominojnë rastet kur nxënësit përshkruajnë situata të dhunës në veten e tretë, por ka raste kur nënkuptohet se edhe vetë kanë qenë objekt i dhunës, qoftë fizike ose psikike. Sikurse nxënësit e shkollave të fshatit, ashtu edhe ata të shkollave të qytetit, kanë dhënë raste shumë të një natyre, ku zakonisht subjekt kryesor i dhunës është babai ndërsa objekt nëna. Edhe sa i përket identifikimit të faktorëve dhe pasojave të dhunës, nuk kemi

hasur në dallime domethënëse ndërmjet grupeve të nxënësve sipas përkatësisë gjeografike.

Përmes rrëfimeve të nxënësve, hulumtimi vërteton se dhuna në familje është e pranishme në forma të ndryshme. Nxënësit janë përjetues të drejtpërdrejtë të dhunës ose të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës në familje ndaj ndonjërit nga anëtarët e familjes. Nxënësit në rrëfimet e tyre kanë prezantuar raste të shumta kur fëmijët ishin objekt i dhunës, prandaj përjetimi i dhunës nga ana e tyre mund të sjellë pasoja në të ardhmen. Sipas nxënësve, babai i dhunshëm është shkaktari më i shpeshtë i dhunës në familje ndaj gruas/nënës, por edhe fëmijëve. Problemet ndërmjet çiftit, abuzimi me alkool, tradita dhe gjendja socio-ekonomike e familjes, rezultatet në shkollë dhe roli i mësimdhënësve, dhuna nga bashkëmoshatarët apo sjelljet e tyre asociale, u identifikuan si forma shkaqe më të shpeshta të dhunës në familje ndaj nxënësve.

Nxënësit pjesëmarrës në grupet e fokusit, i kanë identifikuar shkaqet apo rrënjët e prezencës së dhunës në familje. Shumica i kanë identifikuar si burime/shkaqe të dhunës në familje këta faktorë: çështjet socio-ekonomike, alkoolizmin, mungesën e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes e bashkëshortëve në veçanti, nivelin e ulët të edukimit në familje, suksesin/notat jo të mira në shkollë, sjelljen jo të mirë të fëmijëve në shtëpi, divorcin etj.

Pasojat për fëmijët nga dhuna në familje janë të rënda, të paevitueshme. Nxënësit i kanë evidentuar pasojat kryesore, domethënëse për fëmijët, si: humbja e vetëbesimit, agresiviteti, depresioni, mbyllja në vete, rënia e suksesit në mësim, humbja e disponimit dhe mbyllja në vetvete, ndjenja e frikës se dhuna mund të përsëritet, konfliktet me të tjerët, ikja nga orët e mësimit dhe nga shtëpia, rritja e shkallës së agresivitetit, stigmatizimi nga të tjerët. Të gjitha këto shkaktojnë prishjen e balancës së shëndetit mendor dhe fizik të fëmijëve.

Të dhënat statistike, por edhe ato të raportuara në media, tregojnë se dhuna në familje është e pranishme. Fëmijët janë ose objekt i drejtpërdrejtë i

dhunës ose pjesë/element “vëzhgues” i saj, në forma të ndryshme. Prandaj, nga ky hulumtim sugjerohen disa rekomandime lidhur me nevojën për ndërgjegjësim, ndërtim dhe funksionalizim të mekanizmave për parandalimin e dhunës në familje. Gjithashtu, janë dhënë rekomandime për Institucionet e linjës si Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Shëndetësisë etj., për të hartuar dhe iniciuar programe që inkurajojnë parandalimin e dhunës, por edhe që zgjidhin problemet socio-ekonomike dhe të komunikimit të mirëfilltë në familje dhe me familje.

Hulumtimi ishte i kufizuar në pjesëmarrje dhe u bazua në rrëfimet e nxënësve. Në të sugjerohet të studiohen mostër më gjithëpërfshirëse si në numër ashtu edhe me pjesëmarrës të cilët kanë qenë objekt i dhunës në familje.

2. Executive summary

At the request of the Ministry of Education, Science, Technology and Innovation, the Pedagogical Institute of Kosovo has conducted the research "Causes and consequences of violence against students in the family". The phenomenon of man-to-man violence is not unknown. Domestic violence remains one of the most widespread forms of violence practiced worldwide.

The mechanisms built against violence, in Kosovo, mainly deal with the victim and the perpetrator. Prevention and identification are two very important moments in dealing with the phenomenon of domestic violence and violence. For this reason, the relevant institutions and line ministries in Kosovo have foreseen actions and measures related to the education and awareness of society, in order not to tolerate violence in the family, as well as violence against women and children. In this aspect, this study emphasizes the need for effective inter-institutional coordination to enable planning of resources, provision of services, as well as monitoring of their implementation.

The specific subject of the research were school students. The school, as a special and very important mechanism, as an organized and structured institution, with special mission and programs for development of new citizens, plays an important social role in the district where it operates and develops educational programs and activities. In order to better reflect the issue of the presence or absence of aspects of violence against students in the family, the reports and statistics of the institutions/mechanisms responsible for the prevention and addressing of acts of violence and the protection of children from any violence were also the object of the study.

The approach to identifying cases of violence against children in the family, either as an object of violence or a passive part of violence, "observer", was developed in two main aspects of this research. First, the analysis of the policies and reports of the main mechanisms for the protection of children from violence. Second, the inclusion of students' stories, as well as focus group discussions to gather opinions regarding the presence of violence

against them in the family, directly or indirectly. The purpose was to highlight the presence of domestic violence against children in cases where children were the direct or indirect object of violence, as well as to present current policies in relation to the forms of treatment of cases of domestic violence.

The research addressed 5 main questions:

- 1. Is there domestic violence against students? What type of violence, if any, is most common?*
- 2. How do students perceive violence against them or their family members?*
- 3. How do students experience physical and verbal violence against them in the family?*
- 4. What are the causes and consequences of the presence of violence for children, according to the students' perception?*
- 5. What is the role of anti-violence mechanisms to protect children from violence?*

Qualitative approach was used for the collection and analysis of relevant data. The research is mainly based on the students' stories about the aspects of domestic violence. Written narratives and focus groups with students were used for data collection. Analysis of relevant policies and documentation was also part of the qualitative data analysis. Part of the sample were students (N= 181), services in Social Centers for the Protection of Children (N= 4), police officers (N= 3) responsible for addressing cases of violence against children, as well as representatives of mechanisms for the protection of children, and officials from the Ombudsperson Institution. The sample of students consisted of students from 12 city and village schools, from grades VI, VII, VIII and IX.

In addition to the examination of official documents and field research with students, officials of the institutions responsible for the protection of

children were interviewed, such as: the Office of the Ombudsperson, the Kosovo Police, and the Centers for Social Work. These institutions collect data/reports on cases of general violence in the family, but specifically on the experience of the child as a subject of violence or witnessed exercise of violence against others. Their reports prove that the phenomenon of domestic violence is highly present in Kosovar society. Increased institutional commitment to address domestic violence, adequate distribution of resources, improved communication and cooperation between parties, increased professional training for general response to domestic violence, development of comprehensive rehabilitation programs for victims, psychological support for victims of violence and the rehabilitation of the perpetrators through various programs, are some of the actions planned by the interviewed institutions.

Attitudes and thoughts of students regarding the occurrence of domestic violence against students were collected in two forms:

1. Through the written answer to the question: Can you describe any case that you know of violence against a friend that happened to him/her in the family?
2. Discussion in focus groups regarding the causes and consequences of domestic violence.

The question was addressed in this way to avoid the personal experience of the students, whether he/she was subject to violence or was present in cases where violence was inflicted on other persons. Discussion in focus groups resulted in the identification of causes and consequences according to the students' perspective.

The collected data are based on the individual narratives of students regarding cases of domestic violence, either directly against them or as passive participants. Cases dominate when students describe situations of violence in the third person, but there were cases where it was implied that they themselves have been the object of violence, either physical or psychological. Both students from rural schools and those from city schools

have given cases of a very similar nature, where usually the main subject of violence is the father, while the object is the mother. Even in terms of identifying the factors and consequences of violence, we did not encounter significant differences between groups of students according to geographic affiliation.

Through the students' stories, the research proves that domestic violence is present in different forms. Students directly experienced violence or were present during domestic violence against any of the family members. In their narratives, the students have presented numerous cases when children were the object of violence, therefore experiencing violence on their part may bring consequences in the future. According to the students, the violent father was the most frequent cause of domestic violence against the wife/mother, but also their children. Problems between the couple, alcohol abuse, tradition and socio-economic status of the family, school results and the role of teachers, violence by peers or their antisocial behavior, were identified as the most frequent causes of family violence against students.

The students participating in the focus groups identified the causes or roots of the presence of violence in the family. Mostly they identified the following factors as sources/causes of domestic violence: socio-economic issues, alcoholism, lack of communication between family members and spouses in particular, low level of education in the family, success/bad grades at school, children's bad behavior at home and divorce.

The consequences for children from domestic violence are serious and unavoidable. Students identified the main consequences, significant to children, such as: loss of self-confidence, aggressiveness, depression, withdrawal, decreased success in lessons, loss of mood and withdrawal, feeling of fear that violence may be repeated, conflicts with others, running away from classes and home, increasing the degree of aggressiveness, stigmatization by others. All these cause disruption of the balance of mental and physical health of children.

Statistical data, but also those reported in the media, show that domestic violence is present. Children were either the direct object of violence or part/observer element of it, in different forms. Therefore, this research offers recommendations regarding the need for raising awareness, and construction and operationalization of mechanisms for the prevention of domestic violence. Also, recommendations have been given for line Institutions such as the Ministry of Education, Science, Technology and Innovation; Ministry of Labor and Social Welfare; Ministry of Health, etc., to design and initiate programs that encourage the prevention of violence, but also that solve socio-economic problems and proper communication within families and for families.

The research was limited in terms of participation and was primarily based on students' stories. It is suggested that more comprehensive studies are conducted with larger samples and with participants who have been the object of domestic violence.

3. Hyrje

Dukuria e dhunës njeri-njeri nuk është e panjohur. Raportet e përditshme në media, pastaj ato të mekanizmave për mbrojtjen nga dhuna, dëshmojnë se kjo dukuri jo e mirë është e pranishme në familjet kosovare. Në bazë të teorisë së subkulturës së dhunës, prezenca e dhunës në një shoqëri ka karakter të një trashëgimie brez pas brezi. Kjo bartje e dukurisë së dhunës nuk është e pranishme vetëm në Kosovë. Dhuna në familje mbetet një ndër format më të përhapura të dhunës, të ushtruar në mbarë botën. Një transmetim të tillë të dukurisë së dhunës në familje e kanë determinuar faktorë të ndryshëm (Rattanavicha et al., 2021).

Parandalimi dhe identifikimi janë dy momente shumë të rëndësishme në trajtimin e fenomenit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Parandalimi është ngushtësisht i lidhur me edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë. Nëse faktorët që e nxisin e përshkallëzojnë dhunën të tillë si paragjykimet, stereotipat gjinorë, diskriminimi gjinor dhe i shumëfishtë, efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore etj., do të trajtohen që në fëmijërinë e hershme dhe nëse do të investohet vazhdimisht në edukimin e vetëdijesimin e shoqërisë për të mos e toleruar dhunën në familje, gradualisht do të shkohet drejt zvogëlimit të numrit të rasteve të ushtrimit të këtyre formave të dhunës. Për këtë arsye, në objektivat specifike të strategjisë, janë parashikuar veprime dhe masa të lidhura me edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë, për të mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Puna me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe bizneset, është gjithashtu e rëndësishme dhe ndihmon, si në identifikimin e rasteve të dhunës, edhe në parandalimin e saj (Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, 2022 – 2026).

Familja kosovare ende ka elemente të konservatorizmit, prandaj edhe buron “e drejta” e mashkullit për të dominuar, urdhëruar dhe monitoruar anëtarët e familjes, e cila mbijeton ende. Kjo “e drejtë” për të dominuar dhe monitoruar të tjerët burrit ia ka dhënë “të drejtën” edhe për të ushtruar dhunë, ndaj gruas në rend të parë, si dhe për të disiplinuar anëtarët e tjerë të familjes. Të dhënat

nga hulumtimet tregojnë se ende një përqindja e lartë e qytetarëve kosovarë e pranojnë këtë si një veprim normal, se burri nganjëherë mund ta rrahë gruan e vet. E njëjta gjë konfirmohet edhe ndaj fëmijëve, për t'i disiplinuar ata.

Të gjitha ligjet dhe konventat, vendëse dhe ndërkombëtare, burrit ia mohojnë këtë “të drejtë” të trashëguar brez pas brezi. Megjithatë, më e fuqishme del të jetë subkultura e dhunës sesa ligjet dhe konventat ndaj dhunës (Rattanavicha et al., 2021).

Vetëm ekzistenca e kuadrit ligjor kombëtar, strategjive, politikave dhe planeve të veprimit, apo konventave ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, nuk mjaftojnë për të përmirësuar situatën dhe për të reduktuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Aplikimi i masave të mbrojtjes, të shprehura në ligj, duhet të shoqërohet me koordinimin efektiv ndër-institucional që mundëson planifikimin e burimeve adekuate, ofrimin e shërbimeve cilësore, vendosjen e kriterëve dhe standardeve të domosdoshme, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre (Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, 2022 - 2026).

Ngritja e vetëdijes për format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është element i rëndësishëm në parandalimin e dhunës, sepse vetëdija e rritur është hapi i parë drejt ndryshimeve të qëndrimeve dhe sjelljeve që i nxisin ose i lejojnë format e ndryshme të dhunës ndaj grave. Pikërisht për këtë arsye, “edukimi i brezave të rinj, posaçërisht djemve dhe burrave, është i domosdoshëm të fokusohet në përgatitjen e tyre, si aleatë të vajzave dhe grave, për veprimet kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave dhe për të krijuar kështu brezin e barazisë” (Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, 2022 – 2026, f. 38).

Mekanizmat e ndërtuar kundër dhunës, në Kosovë, kryesisht merren me viktimën dhe dhunuesin. Me të parin si të rehabilitohet, të strehohet në vend të sigurt, ndërsa me të dytin si të ndiqen dhe të dëshmohen vërtetësia e aktit të dhunës dhe përgjegjësia penale sipas ligjit. Pra, këta mekanizma kryesisht objekt të fushëveprimit i kanë pasojat e dhunës - viktimën, por jo edhe

parandalimin e dhunës. Dënimi i dhunuesit dhe rehabilitimi i viktimës nuk janë instrumente që garantojnë parandalimin e dhunës, ose përsëritjen e saj. Tek e fundit, dënimi i dhunuesit vetëm mund ta parandalojë ripërsëritjen e akteve të dhunës, por nuk mund të merret si shembull për të tjerët, për të mos ushtruar akte dhune, si mekanizëm parandalimi.

Shkolla dhe institucionet e linjës nuk e kanë në fokus parandalimin e dhunës në familje. Në programet shkollore mësohet për të drejtat e fëmijës, për llojet e dhunës, pasojat nga dhuna, si e drejtë e individit për t'u mbrojtur nga aktet e dhunës, e shumë pak për parandalimin e dhunës në familje, nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm. Në shkolla organizohen veprimtari e punëtori, në të cilat përfshihen nxënës e mësimitdhënës, por edhe ndonjë OJQ, por sa këto ndikojnë ose depërtojnë deri në familje, për parandalim të akteve të dhunës, lë shumë për të dëshiruar. Ndërtimi i bashkësisë familjare, bërthamës së shoqërisë, ekonomisë dhe rritjes së saj, ka mbetur jashtë ndihmës profesionale. Institucionet ndihmojnë familjet për të ndërtuar dhe zhvilluar ekonominë, si një mekanizëm edhe për shmangien apo zbutjen e faktorit socio-ekonomik të dhunës, por, në shumicën e rasteve, kjo nuk është e mjaftueshme. Zbutje e faktorit socio-ekonomik nuk ndikon në ndryshimin e mendësisë për të "drejtën" e trashëguar për të ushtruar dhunë, si mendësi ende e pranuar dhe e pranishme, sipas hulumtimeve dhe raporteve.

Shkolla dhe mekanizmat e tjerë, si dhe OJQ-të, për të eliminuar dhunën në familje, si dhe për t'i shpëtuar fëmijët nga dhuna e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, duhet të fokusohen dhe të depërtojnë brenda familjes, sidomos tek ata që janë në proces të krijimit të familjes, që të ndërjegjësohen se dhuna përveçqë është e ndaluar me ligje e konventa, lë pasoja të papara të trashëgimtarët e tyre: fëmijët. Përveç kësaj, krijimi i këshillimoreve për çiftet e reja është një domosdoshmëri e kohës. Zhvillimi i teknologjisë ka bërë që të ftohen/zbehen raportet ndërmjet anëtarëve të familjes, por edhe ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Këto raporte të ftohura ndikojnë në komunikimin jo të rregullt në familje dhe shpesh bëhen shkak i dhunës ndërmjet tyre.

Ka mungesë të angazhimit institucional për të regjistruar të dhënat në Databazën Nacionale (DN) për rastet e dhunës në familje. Policia e Kosovës është njëri nga institucionet përgjegjëse që bën regjistrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave në këtë databazë. Një mungesë e theksuar e regjistrimit të të dhënave është vërejtur në disa Gjykata Themelore dhe në Prokurori. Po ashtu, rastet e regjistruara në DBN nuk klasifikohen apo prioritizohen në bazë të ndjeshmërisë së tyre. Kjo pengon mobilizimin efektiv dhe planifikimin e duhur të aktiviteteve për adresimin e rasteve specifike të dhunës në familje (Raporti i Auditimit, 2023, f. 2).

Në Kosovë, dispozitat e Kodit Penal që kanë të bëjnë me dhunën në familje, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Ligji i ri për Familjen, duhet të shprehin qartë se parimet e pajtimit nuk aplikohen në rastet e dhunës në familje, duke përfshirë rastet e së drejtës familjare. Më tej, vendimi për politikën duhet të deklarojë se pajtimi mund të mos përdoret si reagim ligjor ndaj dhunës në familje, por vetëm si reagim psiko-social, kur ofrohet nga ekspertë profesionalë, të kualifikuar dhe të licencuar. Avokatët, policia, prokurorët dhe gjyqtarët, nuk duhet të angazhohen në përpjekjet e pajtimit (Farnsworth et al., 2015, f. 13).

Ky studim, i bazuar në rrëfimet e nxënësve, në analizën e politikave dhe raporteve të organeve përgjegjëse, dhe në intervistat me aktorët përgjegjës për funksionalizim të mekanizmave kundër dhunës, ofron dëshmi se dhuna si dukuri ende është e pranishme në Kosovë. Nxënësit janë viktimë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e asaj dhune dhe pasojat për të ardhmen e tyre janë të paparashikueshme. Studimi u realizua me nxënësit e shkollave të Kosovës, prandaj edhe konteksti i studimit është kosovar.

4. Konteksti i problemit

Qasja për identifikimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në familje, qoftë si objekt i dhunës apo pjesë pasive e dhunës, “vëzhgues”, u zhvillua në dy aspekte kryesore. E para, analiza e politikave dhe raporteve të mekanizmave kryesorë për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. E dyta, përfshirja rrëfimeve të

nxënësve, si dhe diskutimi në fokus-grupe për të mbledhur mendimet lidhur me prezencën e dhunës ndaj tyre në familje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Sa i përket aspektit të parë, institucionet kanë hartuar politika të qarta sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga çfarëdo lloj dhune, që ushtrohet ose mund të ushtrohet ndaj tyre në familje. Në këtë aspekt, me mekanizmat që merren me raportin ose mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve, të cilët kanë qenë objekt i dhunës në familje, nuk mund të jemi të kënaqur. Të dhënat e mbledhura nga këta mekanizma janë në nivel të numrave, sa raste janë paraqitur - lajmëruar, por nuk ka të dhëna të sakta për llojin e dhunës, kohën e dhunës, tipin e familjes. Të dhënat janë të mangëta sidomos sa i përket prezencës së fëmijëve në aktet e dhunës në familje, ndërmjet anëtarëve të tjerë, por që konsiderohet si dhunë e tërthortë psikologjike ndaj tyre.

Aspekti i dytë i trajtimit të çështjes së dhunës në familje ndaj fëmijëve, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, paraqet dimensionin më të rëndësishëm të këtij hulumtimi. Diskutimi me nxënës, në fokus-grup, si dhe deklaratat e shkruara nga ta, tregojnë më së miri nivelin e ndjeshmërisë së problemit të dhunës sipas aktorëve pjesëmarrës në ushtrimin e dhunës, qoftë nëse kanë pësuar dhunë, e kanë vëzhguar dhunën, ose kanë dëgjuar përjetimet e dhunës nga fëmijët e tjerë. Pasqyrimin e kësaj ndjeshmërie, por edhe idetë për rrënjët dhe pasojat nga ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve, të cilat nxënësit pjesëmarrës i kanë paraqitur me shkrim dhe në fokus-grup, e kemi prezantuar në analizën e të dhënave.

Ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve, çfarëdo qoftë ajo, ndikon në shëndetin mendor dhe fizik të tyre për kohë të gjatë. Vetë fakti se Qeveria dhe ministritë e linjës kanë hartuar një strategji kundër dhunës ndaj fëmijëve në familje dëshmon se aspekte të dhunës ende janë të pranishme. Edhe pse janë hartuar politika të qarta dhe janë themeluar mekanizma institucionalë dhe të shoqërisë civile, protokolle, sipas të dhënave zyrtare, një dukuri e tillë është ende e pranishme.

Sipas një raporti të ASK (2014), rreth 24% e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç i janë nënshtruar ndëshkimit fizik, rreth 59% dhunës psikologjike, ndërsa

61% çfarëdo forme të disiplinimit të dhunshëm, si dhe rreth 31% vetëm disiplinimit jo të dhunshëm (ASK, MICS, 2014, f. 13). Ndërsa, në Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) Nr. 21, (2021) konstatojnë se “... dukuria e dhunës në familje në Kosovë është e shprehur në përmasa shqetësuese, përmes rritjes së numrit të rasteve të raportuara dhe prezencës së dhunës në familje...” (IAP, 2021, f. 74).

Në rastet e dhunës në familje, në të cilën njëri prind është viktimë e dhunës dhe tjetri është kryerësi, fëmijët mund të jenë edhe më pak në gjendje t'u drejtohen prindërve për mbështetje dhe siguri. Për shkak të rolit të shtetit dhe shoqërisë, që në qendër të vëmendjes kanë “parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës”, edhe gjatë krijimit të normave ligjore dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore dhe administrative, gjithmonë merret për bazë ky parim (Ministria e Shëndetësisë, UA 04/2023¹).

Mekanizmat publikë, shoqëria civile dhe institucionet e tjera, në vazhdimësi, raportojnë për raste të llojeve të ndryshme të dhunës që ushtrohet ndaj fëmijëve, por ende nuk është bërë ndonjë studim i thelluar për të adresuar prezencën e dukurisë së dhunës ndaj fëmijëve. Prandaj, me këtë studim mëtohet të përfitohen njohuri empirike më të thelluara, si dhe të sugjerohen kahet e shmangies ose eliminimit të kësaj dukurie të dëmshme për fëmijët.

Hulumtimi sheshoi disa të dhëna me interes për zbutjen e problemit të dhunës, cilado qoftë, ndaj fëmijëve. Burimet e shqyrtuara flasin për ndikimin dhe për problemet që mund të shkaktojnë te fëmijët akti i dhunës fizike ose psikike në familje.

¹ Ministria e Shëndetësisë (2023). Udhëzimi Administrativ Nr. 04-2023 për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik të Fëmijës – Viktimë e Abuzimit për t'i ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u riintegruar në Shoqëri. <https://msh.rks.gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Udhëz55426924.9277.pdf>

5. Shqyrtimi i politikave dhe literaturës

Si pjesë e shqyrtimit të burimeve që përcaktojnë konceptin e dhunës, fillimisht janë shqyrtuar burimet dhe politikat zyrtare, si: ligjet, udhëzimet administrative, protokollet dhe raportet e mekanizmave publikë për mbrojtjen e individit nga dhuna.

5.1. Shqyrtimi i politikave nacionale

Në politikat aktuale të vendit tonë, por edhe më gjerë, koncepti i dhunës është përfshirë në dokumente dhe politika që adresojnë dhe përvijojnë të drejtat e njeriut, fëmijës, dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Të gjitha konventat, ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë dhe aktet e tjera ligjore, ndalojnë çdo lloj dhune ndaj fëmijëve. Në Kosovë, në shkallë vendi, ekzistojnë strategji, dokumente të veprimit, protokolle e rregullore, të cilat vënë në pah rëndësinë e parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve. Duke u nisur nga fakti se dhuna është problem shumë i madh në familje dhe shkolla, të gjitha këto ligje, rregullore dhe dokumente të tjera, përfshijnë nene dhe pika të veçanta që rregullojnë këtë çështje.

Të drejtat e fëmijës janë garantuar me aktin më të lartë - **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**. Sipas nenit 50, paragrafi 3, secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, e zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë, synon që të rrisë përpjekjen për të garantuar të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë. Kjo e drejtë themelore synohet të arrihet përmes aktiviteteve të parashikuara me këtë strategji në fushën e parandalimit, mbrojtjes, riintegritimit dhe fuqizimit të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ndëshkimit dhe rehabilitimit të kryerësve të këtyre formave të dhunës, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional (MD, f. 9).

Ligji Nr. 06/L-084 (2019) për mbrojtjen e fëmijës - ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi. Ky ligj në detaje përcakton dispozitat e përgjithshme, parimet e mbrojtjes së fëmijës, mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës, masat për mbrojtjen e fëmijës, si dhe masat ndëshkuese për rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Paragrafi 1 i nenit 4 të këtij ligji specifikon se mbrojtja e jetës së fëmijës është detyrimi kryesor për çdo person, institucion apo organ tjetër, kurse paragrafi 2 i të njëjtit nen garanton të drejtën e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, që do të thotë se e drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social, si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje (Nr. 03/L-182, 2010) - përcakton qëllimin, përkufizimet, organet kompetente, masat mbrojtëse dhe ndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Sipas paragrafit të parë të Nenit 1, ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, kurse sipas paragrafit 2, të të njëjtit nen, ligji ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Rregullorja ORK - NR. 21/2013, për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar - përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar. Paragrafët 1.9. dhe 1.10 adresojnë çështjet e dhunës në shkollë në takimet me prindër dhe trajtojnë çështjet e dhunës brenda shkollës, duke i pasur parasysh të gjitha relacionet: nxënës-nxënës, mësues-mësues e anasjelltas, mësues-mësues - mësues, mësues - prindër e anasjelltas,

udhëheqës - mësimdhënës e anasjelltas. Kjo rregullore përcakton edhe detyrimet e Komunes dhe Qendrës për Punë Sociale. Paragrafi 1.7 i nenit 11 të kësaj rregulloreje garanton mbështetjen e familjeve në jetësimin e përgjegjësive e tyre për rritjen e fëmijëve, duke ofruar këshillime mbi prindërimin pozitiv.

Rregullorja për kujdes mjekësor ndaj fëmijëve viktime të dhunës në familje - e nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, parasheh në detaje mënyrën e sjelljes së personelit mjekësor në rastet kur për pacientë kanë fëmijët që kanë statusin e viktimave nga dhuna në familje. Kjo rregullore e ka paraparë në detaje situatën e fëmijës kur paraqitet në rolin e dëshmitarit edhe kur dhuna nuk është e drejtuar kundër tij, pasi edhe kjo situatë konsiderohet e dëmshme për shëndetin e fëmijës dhe sjell pasoja negative. Fëmijët, viktime të dhunës në familje, kanë pasoja me efekte afatshkurtra dhe afatgjata. Efektet afatgjata të dhunës manifestohen me: shqetësime, rëndim të sjelljes apo sjellje agresive, regres në zhvillim, vështirësi në të mësuar, depresion dhe anksozitet, tërheqje nga kontaktet sociale (Ministria e Shëndetësisë, UA 04/2023).

5.2. Konventa e Stambollit për mbrojtjen nga elementet e dhunës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e amendamentuar në vitin 2020², e njeh zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)³, si një instrument për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe për mbrojtjen e viktimave. Kjo konventë është traktati më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Konventa synon të sigurojë tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt.

² Amendamenti nr. 26, dt. 25. 09. 2020, në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9), si në vijim: (9) Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

³ <https://rm.coe.int/168046246b>

Konventa e Stambollit ka për qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të kryesve të dhunës.

Parandalimi ka të bëjë me ndryshimin e stereotipave gjinorë, rritjen e ndërgjegjësimit, bashkëpunimin me OJQ-të, trajnimin e profesionistëve që punojnë me viktimat etj.

Mbrojtja merret me vendosjen e nevojave dhe sigurisë së viktimave, krijimin e shërbimeve dhe strukturave të specializuara për dhënien e ndihmës mjekësore, si dhe këshillimin psikologjik dhe ligjor të viktimave dhe fëmijëve të tyre.

Ndjekja penale, e kryesve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, sipas Konventës së Stambollit, është obligim i të gjitha institucioneve që merren me zbatimin e ligjit. Kjo konventë dhunën ndaj grave e konsideron si vepër penale që dënohet sipas ligjit dhe kërkon që justifikimet në bazë të kulturës, zakoneve dhe fesë, të konsiderohen si të papranueshme për çdo akt dhune, si dhe viktimave t'u sigurohen masa të posaçme mbrojtje gjatë hetimit dhe proceseve gjyqësore.

Konventa mbron të gjitha gratë dhe vajzat, pavarësisht moshës, racës, fesë, origjinës sociale, statusit migrues apo orientimit seksual. Po ashtu, shtetet inkurajohen të zbatojnë konventën dhe për viktimat të tjera të dhunës në familje, si: burrat, fëmijët dhe të moshuarit. Vepra të dënueshme sipas konventës janë dhuna në familje (dhuna fizike, psikologjike ose ekonomike), dhuna seksuale, ngacmimet seksuale, martesat e detyruara etj. (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Konventa e Stambollit, Këshilli i Evropës, 2011).

5.3. Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë

Dhuna në familje është shkelje e të drejtave të njeriut. Shtetet kanë përgjegjësi për të mbrojtur popullsinë e tyre nga shkeljet e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, institucionet e Kosovës, që ofrojnë shërbime për

viktimat e dhunës në familje, kanë hartuar dokumentin Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë⁴ (PSV, 2013).

Qëllimi i PSV është krijimi i një sistemi të koordinuar të institucioneve të Kosovës, të cilat reagojnë në formë të menjëhershme dhe të vazhdueshme në rastet e dhunës në familje, me qëllim të ofrimit të ndihmës cilësore dhe mbrojtjes së viktimës së dhunës në familje. Ky dokument qartëson rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritimit. Me masa aktive dhe reaktive ligjore mbrohet viktimat e dhunës në familje dhe kryhet ndëshkimi ligjor i shkaktuesit të dhunës në familje. Me këto masa përfshihet mbrojtja e pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje dhe në veçanti fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar.

Çdo institucion ka një përgjegjësi për të parandaluar dhunën dhe për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje. Prandaj, ky dokument liston mekanizmat institucionalë dhe aktorët e tjerë, të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në mbrojtje të viktimave nga dhuna në familje, si:

- Policia e Kosovës;
- Inspektorati i Policisë;
- Mbrojtësi i Viktimave/Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
- Prokurori i Shtetit;
- Gjykatat;
- Departamenti i Mjekësisë Ligjore/Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

⁴ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20të%20Veprimit%20për%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20në%20Familje.pdf>

- Komunitat/Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrat për Punë Sociale;
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas/ Zyrrat Rajonale për Ndihmë Juridike;
- Drejtoritë Komunale për Arsim/Institucionet arsimore;
- Institucionet shëndetësore: parësor, dytësor, tretësor dhe Qendrat e shëndetit mendor;
- Zyrrat Regjionale të Avokatit të Popullit.

Në funksion të vetëdijesimit të të gjithë aktorëve përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të dhunës, janë të domosdoshme veprimet e harmonizuara të tyre në funksion të parandalimit të dhunës në familje (Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2013, f. 21).

5.4. Shqyrtimi i literaturës

Me dhunë në familje nënkuptohet maltretimi, lëndimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna seksuale apo psikike, dhuna fizike apo ekonomike - me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikut apo frikës, përfshirë edhe kërcënimet për veprime të tilla, kundrejt bashkëshortit, prindërve dhe fëmijëve apo personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore ose shtëpi të përbashkët. Po ashtu, edhe kundër bashkëshortit të tanishëm dhe të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor apo personit me të cilin kanë fëmijë të përbashkët apo që janë në marrëdhënie personale, pa marrë parasysh se kryerësi e ndan apo e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën. Dhuna në familje është çdo akt dhune, qoftë veprim apo mosveprim i ushtruar ndërmjet personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik (Balili, 2006).

Përveç burimeve që dalin nga politikat për mbrojtjen nga dhuna, janë shqyrtuar edhe burime dhe autorë të tjerë, studime lidhur me dhunën në familje. Dukuria e dhunës në përgjithësi dhe aspektet e ushtrimit të saj ndaj fëmijëve janë trajtuar nga autorë të ndryshëm dhe nga perspektiva të ndryshme. Dhuna ndaj fëmijëve është një problem serioz i shëndetit publik, por edhe shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Globalisht raportohet se mbi 1 miliard fëmijë të moshës 2-17 vjeç kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike, seksuale ose edhe neglizhencë (Hillis, Mercy, Amobi & Kress, 2016, f. 49). Gjithashtu, studimi i bërë nga OBSH-ja (2020)⁵ raporton se 3 në 4 fëmijë përjetojnë ndëshkim fizik dhe psikologjik nga ana e prindërve ose kujdestarëve të tyre, kurse një në katër fëmijë të moshës 5-vjeçare jetojnë me nënën, e cila është duke përjetuar dhunë në familje.

Një studim i realizuar nga Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Banjska, I., Berisha & Morina, D., Rrjeti i Grave të Kosovës (2015), prezanton situatën lidhur me dhunën në familjet kosovare. Të dhënat e këtij hulumtimi tregojnë se me gjithë fushatat e ndërmarra ende është e pranishme dukuria e dhunës në familje, sidomos ndaj gjinisë femërore - gruas, por edhe ndaj fëmijëve. Një e dhënë domethënëse nga ky hulumtim është se 21.1% e kosovarëve besojnë se “nganjëherë është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij”, në krahasim me 18.7% sa ishin në vitin 2008 (Farnsworth et al. 2015, f. 19). Më tutje, hulumtimi konstaton se të anketuarit, të cilët kishin vuajtur nga dhuna në fëmijërinë e hershme, ishin më të prirë të vuajnë nga dhuna më vonë në jetë (Farnsworth et al., 2015, f. 56). Po i njëjti studim nxjerr në pah se rreth 32.6% e kosovarëve pajtohen se “nganjëherë fëmija duhet të dënohet me shuplakë”, që sugjeron se goditja fizike me shuplaka ndoshta ende ekziston në një të tretën e familjeve, si një formë e disiplinës (disiplinimit) të fëmijëve (Farnsworth et al. 2015, f. 49). Kjo dukuri, ose besim i qytetarëve ndaj përdorimit të dhunës, si instrument disiplinimi të fëmijëve, është prezent edhe në vendet e tjera.

⁵ WHO. <https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/332394/9789240004191-eng.pdf?sequence=1>

Një dukuri tjetër është “pajtimi” edhe i grave lidhur me këtë “të drejtë” të burrit për ta goditur gruan, gjë që ndërlidhet me teorinë e nënkulturës së dhunës, sipas së cilës “dhuna kalon/transmetohet përmes një kulture dhune nga brezi në brez” (Rattanaavichia et al., 2021, f. 695). Në Tailandë, dhuna përcillet brez pas brezi, si gjë normale. Me fjalë të tjera, referimi ndaj dhunës në familje, që në moshë të re, është bërë zakon në jetë (Rattanaavichia et al., 2021, f. 689). Ky fenomen i ngjashëm mes dy popujsh, gjeografikisht shumë të largët, tregon për transversalen kulturore ndërmjet popujve, qoftë edhe për dukuritë jo të mira, siç është dhuna në familje dhe ndaj fëmijëve.

Shkalla e saktë e dhunës në familje në një shoqëri nuk mund të vlerësohet kurrë për shkak të raportimeve të pakta. Kështu, në lidhje me shkallën e vlerësuar të dhunës në familje në Kosovë, 31% e kosovarëve (41% e grave dhe 20% e burrave) thanë se ata kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në vitin 2014, duke përfshirë atë fizike, psikologjike, ose dhunën ekonomike. Sipas statistikave, ka gjasa që gratë të përjetojnë dhunë në familje më shumë se sa burrat. Ndërsa kosovarët kanë qenë të prirë të besojnë se dhuna ndodh më shumë në familjet e varfra, rurale ose të paarsimuara, dëshmitë e kundërshtojnë këtë. Nuk ka ndonjë marrëdhënie statistikore të rëndësishme në mes të përjetimit të dhunës në vitin 2014 dhe vendndodhjes gjeografike (rurale/urbane ose rajonale), nivelit arsimor, marrjes së ndihmës sociale, të ardhurave të familjes, respektivisht të ardhurave individuale të të anketuarve (Farnsworth et al., 2015, f. 6).

Studime të ndryshme kanë identifikuar problemin e dhunës së ushtruar ndaj nxënësve duke potencuar ndjeshmërinë e nxënësve ndaj fyerjeve dhe fjalëve të rënda të mësuesve (Potera et al., 2012). Si pasojë e dhunës së ushtruar, qoftë verbale apo fizike, është rritur edhe shkalla e pasigurisë së nxënësve në shkolla (Mekolli, 2015). Prandaj, roli i institucioneve arsimore dhe edukative për të përgatitur dhe zbatuar strategji dhe programe specifike për parandalimin dhe uljen e nivelit të dhunës ndaj nxënësve në shkolla është qenësor (Mazreku, 2012). Ky mekanizëm është treguar pozitiv për faktin se identifikon ngecjet dhe rekomandon zgjidhje konkrete për të rritur shkallën

e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve përgjegjëse, me qëllim të parandalimit të fenomenit të dhunës në familje (GLPS, 2023).

Rezultatet nga Raporti i Auditimit (2023) tregojnë se, edhe pse institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave. Për të realizuar efektivitetin e shërbimeve të ofruara kërkohet më shumë angazhim institucional. Sistemi shtetëror ka mangësi në angazhimin e hetuesve primarë, përfshirje të mbrojtësve të viktimave, shqyrtim të rasteve me kohë nga organet e drejtësisë, si dhe regjistrim të rasteve të raportuara. Viktimat nuk kanë përkrahje sociale, në veçanti mungon përkrahja e tyre në aspektin ekonomik.

Gjithashtu, mungojnë programet për trajtimin e kryesve të veprës (Raporti i Auditimit, 2023).

Ka mangësi në angazhimin adekuat të burimeve njerëzore, në procedurat e monitorimit dhe në mbështetjen e viktimave gjatë rehabilitimit. Policia gjatë intervenimit dhe ofrimit të shërbimeve emergjente reagon në kohë optimale, mirëpo janë identifikuar dobësi në angazhim të hetuesve policorë, mungesë e procedurave për monitorimin e urdhrave mbrojtës, mospërcjellje e informatës të mbrojtësit e viktimave, si dhe dobësi në regjistrimin e rasteve. Nga ana e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, janë vërejtur raste të patrajtuara, mangësi në përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit, si dhe dobësi në udhëzimet për kompensim të dëmit. Kurse në Qendrat për Punë Sociale ka mungesë të përcaktimit të punëtorëve socialë, të cilët duhet të merren vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe mungesë të trajtimit të kryesve të veprës. Dhuna është një dukuri negative, që shkakton probleme jo vetëm për shoqërinë si tërësi, por edhe për të ardhmen e fëmijëve që vijnë nga familje të dhunshme (Raporti i Auditimit, 2023).

Dhuna në familje në Republikën e Kosovës mbetet një ndër problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria. Raporte të ndryshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, konstatojnë praninë e dhunës në familje, si dhe pranimin e përdorimit të dhunës si mjet disiplinimi dhe edukimi, duke e pranuar

nënshtrimin të “autoriteti” (Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, f. 38).

Strategjia e Arsimit 2022 – 2026 (MASHTI, 2022) parasheh organizimin e aktiviteteve, të cilat kontribuojnë në zbatimin e masave për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës (fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin), homofobisë, bullizmit, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit në shkolla. Në strategji parashihen edhe aktivitete që ndërlidhen me obligimet e institucioneve arsimore për të identifikuar, referuar dhe mbështetur fëmijët, të cilët, potencialisht, janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në shtëpitë e tyre, ose dëshmitarë të dhunës në familje, në shtëpitë e tyre. Prandaj, një koordinim ndërinstytucional për të harmonizuar veprimet dhe për të adresuar këtë problematikë është shumë i nevojshëm (MASHTI, 2022).

5.5. Konceptet kryesore të dukurisë së dhunës ndaj fëmijës

Koncepti bazë i këtij hulumtimi është dhuna, prandaj është me rëndësi prezantimi i këtij koncepti të ndërlidhur me legjislacionin dhe literaturën. Bazuar në politikat publike dhe në literaturën relevante, janë përzgjedhur disa nga konceptet, të cilat adresojnë aspektet e dhunës ndaj fëmijëve në familje.

Në **LIGJIN NR. 06/L-084 (2019)** për mbrojtjen e fëmijës janë dhënë përkufizimet, të cilat adresojnë dhe orientojnë çështjet që përfshijnë të gjitha aspektet e mbrojtjes nga çfarëdo lloj dhune dhe ngado që mund të vijë ajo. Në nenin 3, përkufizimet, me këtë ligj përcaktohen:

Pika 1.5. Përgjegjësi prindërore – nënkupton obligimin e prindit për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raport vetjak me fëmijën dhe obligimin për t'i

siguruar fëmijës mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

Pika 1.7. **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual...

Pika 1.22. **Dhunë** – nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhues, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit apo forcës. Dhuna përfshin, por nuk kufizohet në veprat apo veprimet e qëllimshme që i bën një person personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo kanos dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit; sulmi fizik, pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

Vetë koncepti dhunë, qoftë si dukuri ose veprim, ka kuptimin e shkaktimit të dhimbjes tjetrit. Por koncepti më i gjerë përfshin edhe aspekte të tjera të dhunës, përveç asaj fizike. Konceptet e identifikuar nga nxënësit, por edhe nga hulumtimi i Farnsworth et al. (2015), thuhet janë në një linjë me konceptet e verifikuara edhe në aspektin teorik. Në fjalorët e ndryshëm me këtë koncept zakonisht nënkuptohet veprimi/akti fizik, me mjete të ndryshme, mbi personin tjetër.

Sipas K. Grillo (2002), dhuna është veprim i qëllimshëm, për ta detyruar tjetrin, me mjete fizike apo psikike, t'u nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të dikujt (Grillo, 2002, f. 62). Disa koncepte të ndërlydhura me

dhunën, sipas literaturës (Grillo, 2002; Deva-Zuna, 2008; Nushi, 1987; FGJSSH) përfshijnë:

- **ankth** - ndjenjë e pakëndshme frike, mërzi, dhe shqetësim për të ardhmen, të cilat i shkakton dyshimi për arritjen e rezultatit përfundimtar të një veprimtarie individuale (Grillo, 2002, f. 20).
- **depression** - gjendje që manifestohet me rënien shpirtërore, me ndryshime negative në proceset intelektuale, emotive dhe në krejt veprimtarinë e individit (Grillo, 2002, f. 54).
- **dhunë** – përdorimi i forcës fizike, i shtrëngimit fizik ose psikik, i mjeteve e i metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit e dëshirës së tij, për ta nënshtruar e për ta shtypur dikë, për të kufizuar veprimet e dikujt etj. (FGJSSH).
- **dhuna** - është përkufizuar si veprim i qëllimshëm për ta detyruar tjetrin, me mjete fizike a psikike, t'u nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të dikujt (Grillo, 2002, f. 62; Nushi, 1987).
- **dhunë e tërthortë** - formë e dhunës, e cila nuk atakon drejtpërdrejt personin e caktuar, por personi e përjeton keq dhunën ndaj tjetrit, e i cili emërtohet si viktimë e tërthortë e dhunës (Deva - Zuna, 2008, f. 6).
- **frikë** - ndjenjë shqetësimi që shfaqet në reagimin e individit ndaj situatave të papritura, që i konsideron të rrezikshme për personalitetin e vet dhe që nuk është i gatshëm t'i përballojë (Grillo, 2002, f. 90).
- **vetëbesim, humbje e besimit në vetvete** - besimi në vetvete apo në forcat e veta. Pra, humbja e besimit në forcat e veta për zgjidhjen e problemeve ose situatave (sipas FGJSSH).
- **vetëvrasje** - problemi kryesor i kësaj dukurie është shmangia, sjellja patologjike e ankthshme, zakonisht është pasojë e konflikteve në dashuri, në martesë etj. Mungesë e aftësisë për t'u përballur me

realitetin ose gjendjen e krijuar nga rrethana të padëshirueshme (Grillo, 2002, f. 329).

6. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte vërja në pah e prezencës së dhunës në familje ndaj fëmijëve në rastet kur fëmijët ishin objekt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhunës. Më tutje, hulumtimi pati për qëllim të paraqesë politikave dhe praktikave aktuale në raport me format e trajtimit të rasteve të dhunës në familje.

7. Rëndësia e hulumtimit

Identifikimi, konstatimi dhe analiza e formave të shpërfaqjes së dhunës dhe pasojave që lë ajo për mirëqenien e nxënësve paraqet një vlerë të shtuar për kahet e orientimit të politikave dhe të praktikave të adresimit profesional dhe institucional të kësaj dukurie.

Objektiv i veçantë i hulumtimit ishin nxënësit e shkollave. Shkolla, si një mekanizëm i veçantë dhe mjaft i rëndësishëm, si institucion i organizuar dhe i strukturuar, me mision e programe të veçanta për formimin e qytetarit të ri, luan një rol të rëndësishëm shoqëror në rrethin ku funksionon dhe zhvillon veprimtarinë arsimore. Prandaj, me anë të këtij hulumtimi, synohet të shqyrtohet dhe të vlerësohen kontributi dhe ndihma e shkollës, si mekanizëm institucional i organizuar në parandalimin e aspekteve të dhunës në familje.

Për ta pasqyruar më mirë çështjen e prezencës ose jo të aspekteve të dhunës ndaj nxënësve në familje, objekt studimi ishin edhe raportet dhe statistikat e institucioneve/mekanizmave përgjegjës për parandalimin dhe adresimin e akteve të dhunës dhe të mbrojtjes së fëmijëve nga çfarëdo dhune. Nga këta mekanizma janë intervistuar dhe analizuar raportet e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në familje, si dhe cilësia e përgjigjes nga këta mekanizma.

8. Pyetjet hulumtuese

Hulumtimi lidhur me shkallën e prezencës së dhunës në familje, të përjetuar nga nxënësit, si dhe shkaqet dhe pasojat e dhunës te nxënësit, është trajtuar përmes 5 pyetjeve kryesore:

1. *A ushtrohet dhunë në familje ndaj nxënësve? Cili lloj i dhunës, nëse ka, është më i shpeshti?*
2. *Si e perceptojnë nxënësit dhunën ndaj tyre ose shokëve/shoqeve të tyre në familje?*
3. *Si e përjetojnë nxënësit dhunën fizike dhe verbale ndaj tyre në familje?*
4. *Cilat janë shkaqet dhe pasojat e prezencës së dhunës për fëmijët, sipas perceptimit të nxënësve?*
5. *Cili është roli i mekanizmave kundër dhunës për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna?*

Pyetjet 1 deri 4 janë trajtuar të integruara, përmes rrëfimeve individuale të nxënësve, me pyetjen kryesore për nxënësit: A mund ta përshkruani ndonjë rast që dini për dhunën ndaj shokut/qes që i ka ndodhur në familje ndaj tij/saj? Ndërsa diskutimi i moderuar në grupe fokusi ofroi mundësi për identifikimin e shkaqeve dhe pasojave të dhunës së përjetuar nga nxënësit. Sa i përket pyetjes së pestë, lidhur me rolin e mekanizmave përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, të dhënat u grumbulluan përmes intervistave me aktorët relevantë, si dhe literaturës aktuale.

9. Metoda

Qasja cilësore është përdorur për grumbullimin e të dhënave relevante. Përveç analizës së burimeve të tjera, hulumtimi kryesisht mbështetet në rrëfimet e nxënësve për aspektet e dhunës në familje. Rrëfimet me shkrim dhe fokus-grupet me nxënës u përdorën për mbledhjen e të dhënave. Ndërsa

analiza e politikave dhe dokumentacionit relevant, që adreson aspektet e dhunës ndaj nxënësve në familje, ligjet dhe konventat për mbrojtjen e fëmijëve etj., do të jenë pjesë e analizës cilësore të tyre.

10. Mostra

Pjesë e mostrës ishin nxënësit (N= 181), shërbimet në Qendrat Sociale për Mbrojtjen e Fëmijëve (N= 4), zyrtarët policorë (N= 3) përgjegjës për adresimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe përfaqësues të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve, si zyrtarë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Mostrën e nxënësve e përbëjnë nxënësit nga 12 shkolla të qytetit dhe të fshatit. Nxënësit e përfshirë janë nga klasat VI, VII, VIII dhe IX. Varësisht nga madhësia e shkollës, u caktua edhe numri i nxënësve për pjesëmarrje në fokus-grup.

Tabela 1

Struktura e mostrës së nxënësve të përfshirë në hulumtim

Nr.	Klasa				Vendi				Gjinia		Të pa dekluar
	VI	VII	VIII	IX	Qytet	Nx.	Fshat	Nx.	F	M	
1		5	5	5			X	15	8	6	1
2		6	7	3	X	16			7	8	3
3	3	7	2	5	X	17			11	6	
4		5	5	7	X	17			9	8	
5		5	5	7			X	17	11	4	2
6		1	6	5			X	12	6	6	
7		6	7	4	X	17			5	10	2
8		5	4	7	X	16			11	5	
9		5	6	5	X	16			7	8	1
10	3	3	3	3			X	12	6	6	
11	3	2	3	5			X	13	7	6	
12			5	8	X	13		13	7	6	
Gjithsej	9	50	58	64	7	112	5	82	95	79	9

Siç shihet, dominojnë nxënësit e klasës IX, ndërsa nxënës të klasës VI nuk janë përfshirë në të gjitha shkollat, sepse disa shkolla kanë hezitur që në grupe të përfshihen edhe nxënësit kësaj klase. Edhe pse nuk e kemi vendosur si kriter suksesin e nxënësve, afro 90% prej tyre kanë deklaruar se në vitin paraprak kanë pasur sukses të shkëlqyeshëm, ndërsa vetëm rreth 10% prej tyre kanë deklaruar sukses shumë mirë. Gjithsej nxënës që kanë dhënë përgjigje, ose janë përfshirë në fokus-grup, ishin 181.

11. Procedurat e mbledhjes dhe përpunimi i të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave janë organizuar takime dhe grupe fokusi me nxënës, kurse me zyrtarë të institucioneve relevante, që adresojnë dhunën në familje, janë realizuar intervista me anën e pyetësorit të intervistës, të cilët paraprakisht janë kontaktuar për të caktuar datën dhe kohën e intervistës dhe punës me fokus-grupe.

Organizimi i takimeve me fokus-grupe u realizua në shkolla, në vende më të përshtatshme për pjesëmarrësit, si në salla, kabinete apo klasë të ndryshme. Pyetjet dhe diskutimet lidhur me mundësitë e prezencës së aspekteve të dhunës ndaj nxënësve në familje u orientuan nga moderatori i grupit të fokusit.

Në fokus-grupe u caktuan nga 12-16 nxënës. Fillimisht u zhvillua një diskutim lidhur me dukurinë e dhunës në përgjithësi, duke u nisur nga rastet për të cilat ata kishin njohuri. Pastaj secili/secila individualisht, për 15 minuta, përshkroi rastet për të cilat ai/ajo ishte në dijeni ose kishte dëgjuar nga të tjerët. Nxënësit u ndanë në grupe, sipas klasës. Secili grup hartoi një grafik në formë të trungut për të paraqitur burimin/shkaqet e dhunës në familje ndaj nxënësve, si dhe pasojat që mund të burojnë nga ajo.

Intervistat me zyrtarë të policisë, të Qendrave për Punë Sociale, si dhe Avokatin e Popullit, u organizuan sy më sy. Në bazë të protokollit të

intervistës, mblodhën shënime me interes për temën. Disa zyrtarë policorë dhe të Qendrave për Punë Sociale, të dhënat na i dërguan me internet.

Përpunimi i të dhënave cilësore është bërë sipas udhëzimeve të Creswell (2007). Së pari janë analizuar rrëfimet, duke bërë ndarjen në kategori të koncepteve kryesore, si dhe në tematikat e identifikuara. Pastaj janë analizuar edhe të dhënat nga grupet e fokusit, duke i paraqitur në formë të hartës dhe në qendër ishte tema Dhuna në familje ndaj nxënësve, ndërsa në degëzimin e hartës janë paraqitur faktorët, shkaqet dhe pasojat e dhunës.

Të dhënat, mendimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve janë përshkruar dhe koduar për të ruajtur anonimitetin e pjesëmarrësve. Pastaj të gjitha shënimet u mblodhën dhe u përpunuan nga ekipi hulumtues.

12. Rezultatet e hulumtimit

Pjesa dërrmuese e të dhënave janë cilësore. Përpunimi i tyre mbështetet në metodologjinë cilësore, ndërsa ndërthurja me analizën e dokumenteve dhe të raporteve siguron trekëndëzimin dhe ndërlidhjen midis të dhënave. Rrëfimet personale dhe intervistat janë paraqitur të koduara, ndërsa të tjerat në formë narrative, tabelore dhe grafike. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se dhuna në familje është e pranishme. Prezencën e saj dhe nxënësit si objekt i dhunës në familje i kemi trajtuar në dy aspekte: dhuna e ushtruar drejtpërdrejt ndaj fëmijëve dhe dhuna e tërthortë, kur nxënësit kanë qenë vëzhgues ose përjetues të dhunës që është ushtruar ndërmjet anëtarëve të familjes.

12.1. Të dhënat nga institucionet përgjegjëse

Përveç shqyrtimit të dokumenteve zyrtare dhe hulumtimit në terren me nxënës, intervistuaam zyrtarë të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, qoftë nga dhuna në familje ndaj tyre ose si pjesë e dhunës që ushtrohet në familje kur fëmijët janë të pranishëm dhe përjetues të saj. Në

kuadër të intervistave janë përfshirë: Zyra e Avokatit të Popullit, Policia e Kosovës, dhe Qendrat për Punë Sociale. Institucionet e renditura mbledhin të dhëna/raporte për rastet e dhunës së përgjithshme në familje, por jo rastet me specifikat për përjetimin e fëmijës si subjekt i dhunës ose i pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës ndaj të tjerëve. Të gjitha raportet dëshmojnë se dukuria e dhunës në familje është shumë e shprehur në shoqërinë kosovare.

Rritja e angazhimit institucional për të trajtuar dhunën në familje dhe shpërndarja adekuatë e burimeve janë hapat kryesorë. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara dhe rritja e trajnimit profesional do të forcojnë reagimin e përgjithshëm ndaj dhunës në familje. Për më tepër, zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit për viktimat, duke përfshirë mbështetjen psikologjike dhe kompensimet materiale, është jetik. Njëkohësisht, adresimi i rehabilitimit të autorëve përmes programeve të synuara është thelbësor për trajtimin dhe rikuperimin e tyre.

Mangësitë në sistemin e menaxhimit të të dhënave, veçanërisht mungesa e angazhimit institucional për regjistrimin e të dhënave në Databazën Nacionale (DN) për rastet e dhunës në familje, pengojnë monitorimin dhe analizën efektive të rasteve të dhunës në familje. Regjistrimi i paqëndrueshëm i të dhënave ndërlikon më tej përpjekjet për të kapur informacion të saktë, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të unifikuar për futjen e të dhënave (Raporti i Auditimit 2023, f. 47).

12.2. Institucioni i Avokatit të Popullit

Nga intervista në Zyrën e Avokatit të Popullit mësuam se ky mekanizëm nuk ka të dhëna relevante sa i përket dhunës në familje ndaj nxënësve. Të dhënat e tyre, bazuar në intervistën e zhvilluar, kanë të bëjnë kryesisht me procedurat gjyqësore ose policore, në bazë të kërkesës së palës së dëmtuar. Ndërsa të dhënat për llojin e dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkaqet e dhunës, kohën e dhunës etj., nuk janë të evidentuara në këtë institucion. Sipas tyre, është evidente se ka dhunë në familje, edhe ndaj fëmijëve, por

mungojnë të dhënat e sakta. Institucioni i Avokatit të Popullit ka të dhëna për rastet e paraqitura në polici, gjykata etj., si dhe për rregullsinë e procedurave për shqyrtimin e rasteve të dhunës.

12.3. Policia e Kosovës

Të dhënat për dhunën në familje i morëm në formë të shkruar nga zyrtarë policorë përgjegjës për çështje të dhunës në familje. Policia e Kosovës, që nga themelimi i saj, i ka trajtuar me seriozitetin e duhur rastet e dhunës në familje. Ndër vite policia ka realizuar edhe fushata vetëdijesuese për pasojat e dhunës në familje, duke e potencuar në vazhdimësi se dhuna nuk ndalet pa u raportuar dhe pa u trajtuar nga organet kompetente. Rastet e dhunës në familje janë raste të ndjeshme dhe qasja e policisë karshi tyre, si parandalimi për dhunën në një rën anë dhe trajtimi i rasteve me seriozitet, ka bërë që të vijnë duke u raportuar më shpesh, ndër vite.

Rastet e dhunës në familje në secilin stacion policor trajtohen nga zyrtarë policorë që kanë kryer trajnime shtesë për raste të tilla, por, gjithashtu, trajtohen në bashkëpunim të ngushtë me Qendrat për Punë Sociale (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, dhe natyrisht me organet e drejtësisë. Sidomos, rastet kur janë të përfshirë fëmijët si viktimë prania e punëtorit të QPS-së është e domosdoshme.

Policia e Kosovës, në vazhdimësi, ka bashkëpunuar me institucionet relevante për të parandaluar dhe nëse ndodhin për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje. Policia ka përdorur forma të ndryshme për të arritur këtë qëllim, si: fushatat, shpërndarja e fletëpalosjeve me porosi konkrete, ligjërata në shkolla etj. Natyrisht se bashkëpunimi me media dhe përdorimi i rrjeteve sociale na ka ndihmuar që porosia jonë të përhapet dhe të shkojë të sa më shumë persona, ngase ky është qëllimi primar, sepse pas vetëdijesimit vije deri te shtimi i njoftimeve për raste të tilla.

Nga Policia e Kosovës janë siguruar disa të dhëna statistikore (tabela 2) për numrin e rasteve të cilësuar si dhunë në familje, për tri vitet e fundit: numrin e viktimave dhe të dyshuarave, përfshirë gjininë e tyre.

Tabela 2

Të dhënat për rastet e cilësuar si dhunë në familje, për tri vitet e fundit

Rastet e dhunës në familje/ vitet	2020	2021	2022
Raste te raportuara	2069	2456	2764
Viktima			
Femra	1636	1986	2294
Meshkuj	465	500	523
Totali i viktimave	2101	2486	2817
Të dyshuar			
Femra	162	282	410
Meshkuj	1939	2270	2428

12.4. Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, të rritur e fëmijë, apo viktimave të dhunës ndaj grave e vajzave, deri në riintegrim dhe fuqizim të qëndrueshëm të viktimës, në koordinim me aktorët e tjerë. QPS ndihmon viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, riintegrim dhe fuqizim i qëndrueshëm i tyre në shoqëri. Çdo viktimitë të referuar i caktohet një menaxhere/menaxher i rastit, e cila/i cili është zyrtarë/zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese, duke ndihmuar personin në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit të rastit (Strategjia 2022-2026).

Qendrat për Punë Sociale (QPS) merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje atëherë kur viktimat kanë nevojë për mbështetje sociale dhe familjare, si dhe në rastet kur fëmijët nën moshën 18-vjeçare kanë qenë të pranishëm gjatë dhunës në familje, qoftë si viktimat apo si dëshmitarë.

Nga raportet e QPS në Prishtinë është vërejtur se nuk ka ndarje të detyrave mes punëtorëve socialë, të cilët do të duhej të merreshin vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Të gjithë punëtorët merren me trajtimin edhe të rasteve të tjera, si: kontaktimi ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, divorcet, delikuenca të miturit, besimi i fëmijëve, përshtatshmëria për adoptim, këshilla martesore dhe keqtrajtimi i fëmijëve. Përveç rasteve të natyrave të ndryshme, me trajtimin e rasteve të dhunës në familje merren 15 zyrtarë/menaxherë të rasteve, të cilët janë staf i rregullt i QPS-së, si dhe 9 zyrtarë të tjerë të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Ndërsa, në QPS në Pejë, deri në fund të vitit 2020, me trajtimin e rasteve të dhunës në familje ka qenë i angazhuar 1 punëtor social, i cili është marrë vetëm me rastet e dhunës në familje. Kurse, gjatë viteve 2021-2022 trajtimi i rasteve të dhunës në familje bëhet nga 4 zyrtarë/menaxherë të rasteve dhe ndarja bëhet sipas radhës.

Mungesa e përcaktimit të punëtorëve socialë vetëm për trajtimin e rasteve të dhunës në familje mund të ndikojë në shërbimet e ofruara nga ana e tyre. Punëtorët socialë, të cilët nuk janë të trajnuar për këtë qëllim, nuk kanë ekspertizë, aftësi dhe kompetencë për të zgjidhur rastet e dhunës në familje (Raporti i Auditimit, 2023).

13. Të dhënat nga nxënësit

Mbledhja e mendimeve dhe qëndrimeve të nxënësve ndaj dhunës në familje është bërë në shkollat e përzgjedhura. Pasi jemi pajtuar me drejtorët e shkollave për qëllimin e prezencës sonë në shkollat, kemi caktuar kohën dhe vendin e zhvillimit të takimit me grupin e nxënësve. Në klasë, apo bibliotekë, nuk ishte dikush tjetër përveç dy anëtarëve të ekipit hulumtues.

Fillimisht krijuam një atmosferë çlodhëse dhe mirëbesimi me nxënësit, pastaj vazhduam me hapat e tjerë.

Në studim janë përfshirë 181 nxënës/e, në formë të fokus-grupit dhe përmes rrëfimeve personale. Për analizë janë përzgjedhur rrëfimet në të cilat përshkruhen raste të dhunës për të cilat nxënësit kishin informata. Lidhur me besueshmërinë, shkallën e besueshmërisë së rrëfimit, mund të konstatojmë dy gjëra më kryesore. Përmbajtja e disa rrëfimeve ishte shumë origjinale dhe e detajuar. Nga kjo mund vlerësojmë se kishte rrëfime nga historia personale. Në grupin tjetër të rrëfimeve bëjnë pjesë ato të përgjithësuara, të supozuara, të dëgjuara, por jo konkrete, ose tregimet e stilit të një moralizimi ndaj dukurive të dëmshme, siç është dhuna, mirëpo jo rrëfime të ndërlidhura me raste konkrete. Rrëfimet e përzgjedhura për analizë e vërtetojnë tezën se ekzistojnë elemente të dhunës ndaj fëmijëve në familje. Kjo ndërlidhet edhe me raportet statistikore për prezencën e dhunës në familje, si ndaj fëmijëve ashtu edhe të dhunës ndërmjet anëtarëve të familjes.

Qëndrimet dhe mendimet e nxënësve lidhur me dukurinë e dhunës në familje ndaj nxënësve, ose në prezencë të nxënësve, i kemi grumbulluar në dy forma. Së pari, nxënësit e përfshirë në mostër zakonisht në shkollat përkatëse, pas një sqarimi të duhur lidhur me dukurinë e dhunës, janë përgjigjur me shkrim në pyetjen: A mund ta përshkruani ndonjë rast që dini për dhunën ndaj shokut/qes që i ka ndodhur në familje ndaj tij/saj?

Pyetja është drejtuar kësisoj për t'i ikur përvojës personale të nxënësve, nëse ndaj tij/saj është ushtruar dhunë ose ka qenë i pranishëm në rastet kur është ushtruar dhuna ndaj personave të tjerë. Nga analiza e përshkrimeve të marra nga nxënësit mund të nxjerrim përfundime se disa prej tyre kanë përshkruar dhe prezantuar edhe përvojat personale.

Të dhënat e mbledhura mbështeten në rrëfimet individuale të nxënësve lidhur me rastet e dhunës në familje, qoftë drejtpërdrejt ndaj tyre ose si pjesëmarrës pasivë. Qasja e analizës mbështetet në përmbajtjen e rrëfimeve të nxënësve. Sipas Jane Elliot (2005), nuk është e nevojshme të supozohet se kandidati pjesëmarrës do të japë një rrëfim objektiv ose plotësisht të

vërtetë, por është e preferuar të merret një histori që pasqyron interpretimet dhe vlerat e individit (Elliot, 2005, f. 39). Prandaj, rrëfimet individuale të nxënësve, me shumë ngjashmëri për rastet dhe vendet, ishin me interes për trajtimin e kësaj dukurie të dëmshme për nxënësit/individët.

Dominojnë rastet kur nxënësit përshkruajnë rastet e dhunës në veten e tretë, por ka raste kur nënkuptohet se edhe vetë kanë qenë objekt i dhunës, qoftë fizike ose psikike. Sikurse nxënësit e shkollave të fshatit, ashtu edhe ata të shkollave të qytetit, kanë dhënë raste shumë të një natyre, ku zakonisht subjekt kryesor i dhunës është babai ndërsa objekt nëna. Edhe sa i përket identifikimit të faktorëve dhe pasojave të dhunës, nuk kemi hasur në dallime domethënëse ndërmjet grupeve të nxënësve sipas përkatësisë gjeografike.

Hapi i dytë i mbledhjes së të dhënave është bërë në grupe të vogla fokusi. Nxënësit paraqitën mendimet e tyre në formë grafike, lidhur me shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje ndaj nxënësve ose në praninë e tyre. Lidhur me prezantimet e grupeve, u zhvilluan diskutime duke e plotësuar me ide e sugjerime të nxënësve grafikën e shkaqeve të ndryshme dhe pasojave eventuale të dhunës në familje ndaj nxënësve.

13.1. Gjetjet kryesore nga rrëfimet e nxënësve

Studimi, përmes rrëfimeve të nxënësve, vërteton se dhuna në familje është e pranishme në forma të ndryshme. Nxënësit janë përjetues të drejtpërdrejtë të dhunës ose të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës në familje ndaj ndonjërit nga anëtarët e familjes. Nxënësit në rrëfimet e tyre kanë prezantuar raste të shumta kur fëmijët ishin objekt i dhunës, prandaj përjetimi i dhunës nga ana e tyre mund të sjellë pasoja në të ardhmen.

Elementi më i shpeshtë, i cekur nga nxënësit, i dhunës në familje është babai i dhunshëm, i cili sillet keq ose edhe ushtron dhunë ndaj gruas/nënës, por edhe fëmijëve. Si shkak më i shpeshtë i shfaqjes së dhunës është prindi alkoolist, ose edhe problemet e tjera socio-ekonomike. Kjo ka të bëjë kryesisht me presionin apo dhunën e tërthortë që përjetojnë fëmijët kur

përjetojnë raporte të tilla në familje, ose ndërmjet vetë prindërve. Më së shpeshti në rrëfimet e nxënësve kemi identifikuar dhunën fizike, si rrahje, dhe psikike e verbale. Elementet e dhunës fizike ndaj fëmijëve janë paraqitur përmes rrëfimeve, si raste kur kishte shenja në trup, por pa rrëfyer për mënyrën dhe mjetet e dhunës.

Gjatë përpunimit, analizës së të dhënave, rrëfimeve të shkruara të nxënësve, kemi identifikuar disa tema me interes për diskutim, si:

- Dhuna nga bashkëmoshatarët dhe sjelljet asociale të nxënësve;
- Suksesi në shkollë dhe ndikimi i mësimdhënësve;
- Marrëdhëniet jo të mira ndërmjet prindërve;
- Sjelljet abuzive si pasojë e traditës dhe gjendjes ekonomike;
- Abuzimi me alkool nga prindi (babai).

Secila nga këto tema janë analizuar dhe ilustruar me shembuj konkret nga rrëfimet origjinale të nxënësve pjesëmarrës në studim.

13.1.1. Dhuna nga bashkëmoshatarët dhe sjelljet asociale të nxënësve

Nxënësja e klasës së 8-të, nga qyteti, parqet një dimension të dhunës së dyfishtë ndaj shoqes së saj. Si shkak i gjendjes familjare, ndaj saj ushtrohet dhunë psikike në shkollë nga ana e nxënësve të tjerë.

Dhuna ndaj këtij personi ka qenë psikologjike. Shumë nga shokët e klasës e kanë bullizuar apo të themi e kanë dhunuar në mënyrë psikike për problemet që ka pasur ajo në familje. Këto dhunime, si në klasë edhe nëpër rrjete sociale e ndryshuan shumë atë person. Para këtyre problemeve, ajo ishte një vajzë e shoqërueshme, e dashur, e lumtur gjatë gjithë kohës, e cila kishte edhe shumë veti të tjera të mira. U shndërrua në një person komplet tjetër, nuk i besonte

askujt dhe ishte e mërzhitur gjatë gjithë kohës. Kohët e fundit ajo po vuan nga probleme të ndryshme me shëndetin mendor, të cilat po ndikojnë në arritjen e sukseseve në shkollë. Ajo është në gjendje të flasë me mua, por jo me ndonjë të rritur. Unë ndihem shumë mirë që ajo më beson dhe ka guximin të tregojë për problemet e saj.

Ky lloj i dhunës së dyfishtë, siç edhe është përshkruar nga kjo nxënëse, mund të lë pasojat të gjata në jetën e individit. Dëmtimi i shëndetit mendor mund ta çorientojë personalitetin e individit.

Rasti tjetër, i përshkruar nga një nxënëse së klasës VIII, nga qyteti, ka ngjashmëri me rastin paraprak. Tani rasti i dhunës vjen nga vëllai i nxënëses, por për të cilin ishin në dijeni edhe shokët e klasës.

Këtë rast po e shkruaj nga një histori e shoqes time, i cili është plotësisht i vërtetë. Në këtë histori nuk merr pjesë dhuna verbale por një pjesë e madhe dhunës psikologjike, e gjitha kjo për probleme dhe arsye të shumta që vinin nga vëllai i saj. Për shkak të kësaj çështjeje ajo filloi të ndryshoj edhe personalitetin e saj të vërtetë, që e bëri atë të anashkalohej nga shoqëria pavarësisht problemeve familjare. Ishte një vajzë shumë e sjellshme por me trauma të shumta ngase ky problem filloi të përhapej edhe në klasë, u nxiten debate të pambaruara, pra që nuk kishin fund.

Rasti tjetër është një perceptim i një nxënëseje të klasës VII, nga qyteti. Si shkaktar të dhunës ndaj shoqes së saj nga ana e prindërve e sheh sjelljen e vetë vajzës. Edhe pse në njëfarë mënyre e fajëson vajzën se kishte “dalë nga vetja”, është fjala për ndonjë sjellje adoleshenteje, pasojat i përshkruan ashtu siç ajo i ka perceptuar.

Dhunë unë mendoj se u është bërë disa shoqeve të mia që i kam në një lagje, në një ndërtesë, dhe shumë dhunës u kanë bërë prindërit e saj për shkak të daljes së vajzës nga vetja, duke bërë gjëra që një

vajze nuk i kanë shumë hije. Mirëpo, kjo dhunë, që e i kanë bërë te vajza, nuk ka ndikuar fare mirë, sepse vajza është rritur me trup, por mendja e saj nuk është aq e zhvilluar dhe ajo mendon se të tjerët nuk janë asgjë para saj. Dhuna që i kanë bërë ka ndikuar që vajza të bëhet më agresive, e ka bërë vajzë që të futet në burg, gjë që nuk është fare e mirë dhe vetë prindërit janë ndier keq për gjërat dhe thashethemet që i kanë dëgjuar nga njerëzit e tjerë për vajzën e saj. Prindërit, unë mendoj, kanë gabuar, sepse nuk i bëhet dhuna fëmijës që e ka lindur e ka rritur dhe ka bërë gjithçka për të. Nuk besoj se do të ketë fund të mirë në të ardhmen.

Rastet e dhunës ndaj fëmijëve, për shkak të sjelljeve të tyre, janë dukuri e njohur dhe paraqiten në disa tregime të nxënësve. Një rast të tillë e rrëfen nxënësi i klasës VIII, nga qyteti.

Një shok, me të cilin po bisedonim, nuk ndihej aq i lirë teksa po fliste. Unë e pyeta disa herë pse ndihet ashtu, por refuzoi të tregonte. Pastaj e pyeta edhe një herë, duke i treguar se ai mund të më tregonte çdo gjë dhe pastaj më tregoi se, për shkak të një gabimi që ai kishte bërë, kishte disa përçarje në familje. Prindërit e tij kishin parë që ai po fshihte diçka. Kështu që i kishin kontrolluar çantën dhe i kishin gjetur disa armë të ftohta. Pas kësaj, ai tha që prindërit filluan të ziheshin me njëri-tjetrin, duke i treguar njëri-tjetrit se ai ose ajo nuk ishin të aftë që ta rritnin një fëmijë. Pas kësaj, babai e kishte qortuar dhe e kishte goditur atë disa herë për sjelljet e tij të këqija. Pas kësaj, ai filloi të binte në mësim, derisa atij iu ndërrua shkolla me vetëdëshirë. Tani, fatmirësisht, ai është penduar, e ka kuptuar gabimin, dhe gjithçka është në rregull.

Një nxënës i klasës IX rrëfen për një nxënës i ardhur nga një shkollë fshati në qytet, por i cili kurrsesi të adaptohej me mjedisin e ri. Kështu që dhuna ndaj tij, nga bashkëmoshatarët, por edhe nga prindërit, rrodhi si pasojë e sjelljeve të tij. Ky nuk ishte rast i vetëm i kësaj natyre.

(...) Ai humbi shoqërinë që kishte nga shkolla e fshatit. Ai u kërkonte prindërve doemos të mos shpërnguleshin nga fshati, por për arsye financiare familja e tij u detyrua të shpërngulet. Kur erdhën në qytet (NN), ai u bë pjesë e një shkolle të re dhe u bë pre e bullizmit për faktin se ishte nga fshati. Ai nuk e ndau këtë rast me familjen e tij, me ç'rast tek ai ndikoi keq në aspektin psikik, duke i dhënë depresion. Ai që nga ajo kohë filloi të humbte interesin për mësim, deri në një kohë kur filloi të konsumonte duhan. Kjo vazhdoi për tre vjet, përderisa erdhi dita që prindërit e kapën duke pirë duhan. Ata u nervozuan jashtë mase dhe ushtruan dhunë të rëndë fizike në të. Përgjatë kohës që ai pinte duhan, qante shumë, mbyllej vetëm në dhomë, sillej ashpër me familjen, nuk kalonte kohë me ta. Ndoshta kjo ka ndodhur edhe nga mospërcjellja e duhur e prindërve ndaj tij. Megjithatë, edhe pse ai ishte pre e dhunës fizike, e cila i la pasoja të renda, nuk e ndaloi duhanin. Prindërit e tij e përzunë nga shtëpia dhe ai vazhdon jetën sot e tutje rrugëve.

13.1.2. Suksesi në shkollë dhe ndikimi i mësimdhënësve

Rezultatet jo të mira në shkollë paraqiten si shkak i shpeshtë i dhunës në familje. Një përshkrim të dukurisë së dhunës i bën një nxënës i klasës IX, qytet. Në rastin e tij shihen disa faktorë të që ishin burim i dhunës ndaj rasti për të cilin flet ky nxënës. Shkak i dhunës ndaj këtij rasti ishte mungesa e kapacitetit për sukses më të mirë, ashtu siç dëshironin prindërit.

Dhuna në përgjithësi është ekstremizmi i veprimit të njeriut ndaj njëri-tjetrit. Në shoqërinë time kanë ndodhur disa raste të dhunës, një prej tyre në krahun ekstremist, i cili edhe ndikoi në aspektin mendor të viktimës. Ai është rrahur nga familjarët e tij, sepse nuk kishte kapacitet që të arrinte të gjitha notat në favor të prindërve të tij. Ai, përveçse është bërë nervoz me shoqërinë e tij, pastaj edhe i injoronte ata, sepse në fund të fundit tek ai është përdorur dhunë psikike dhe është më se normale që ai të mos jetë dakord me shoqërinë e tij. Pastaj atij i humbi dëshira për shoqëri dhe vendosi

që të rrijë vetëm. Atij po ashtu nuk i pëlqenin ushqimet dhe pothuajse filloi të bie në depresion të vogël, por, për fat të mirë, pas disa kohësh, nuk është përdorur dhunë, sepse unë mendoj se është krijuar vetëbesimi i prindërve ndaj djalit të tij.

Rasti që përshkruan nxënësi i klasës VIII, qytet, është shumë i rëndë. Dhuna ndaj fëmijëve në familje ishte shkaktuar për shkak të ngacmimit të vajzës nga ana e mësimitdhënësit. Rasti i dhunës, siç e përmend ai, kishte ndodhur në një shkollë fshati, për të cilin kishte njohuri të sakta. Rasti tanimë kishte kaluar edhe në organe të ndjekjes, por dukuria e mosbesimit nga ana e familjes në nxënëset viktimë ishin rast për analizë.

“...një rast, i cili ka ndodhur në një shkollë, një arsimtar ka ngacmuar dy vajza seksualisht. Me të cilin ato dy vajza janë ndier shumë keq për ta ndarë këtë lajm përderisa e morën vesh e gjithë shkolla me të cilën drejtori/drejtoresha reagues, duke mbajtur një mbledhje me mësimitdhënësit dhe duke marrë vendimin që ai arsimtar të pushohet nga puna, sepse pasi e kuptuan nxënësit e tjerë ata ndiheshin në siklet ta mbanin orën mësimore. Kur dëgjova se prindërit e atyre vajzave kishin ushtruar dhunë fizike sepse nuk u kishin besuar vajzave të tyre. Kjo kishte ndodhur edhe pak derisa ka ndodhur prapë dhe e kanë kuptuar prindërit.

Problemi i stigmës është ende prezent në mendësinë tonë dhe jo gjendja e fëmijëve, si dhe dukuria e shëmtuar, siç është ngacmimi seksual. Nxënësjat tjetër e klasës VIII, qytet, rrëfen një rast, i cili mund të jetë edhe personal, pasi që kërkon mirëkuptim, që të mos e marrë vesh kush për rrëfimin e saj. Nga përshkrimi i detajuar që i bën rastit është më unik se rastet tjera. Përshkrimi i gjendjes së saj në shkollën e mësimi flet shumë për përjetimin e dhunës në familje ndaj fëmijës. Në përshkrim flet qartë edhe për pasojat nga ushtrimi i dhunës kundër saj. Edhe pse flet në vetën e tretë, rrëfimi është domethënës.

Kam një të afërme e cila është e ndikuar nga dhuna. Dhuna ndaj saj ka ndikuar që të jetë tip më nervoz. Nervozizmi i saj ka arritur në atë shkallë sa nervozohet edhe për gjësendin më të vogël. Interesi i saj në mësimet po ashtu edhe në gjëra të tjera është zvogëluar dhe tani nuk i intereson pothuajse asgjë se çfarë bëhet me jetën e saj. Ajo ishte një nxënëse e cila kishte notat më të mira në klasë dhe dhuna ndikoi që ajo të bjerë në mësimet. Dhuna dhe presioni ndaj saj ishin të tepërta, gjë që mund ta dërgojë drejt depresionit, stresit, frikës etj. Unë e kuptova që ajo ishte e ndikuar nga dhuna kur më kërkoi ndihmë se çfarë të bënte me jetën e saj, sepse ishte e lodhur dhe donte që t'i jepte fund. Vërejtja ca shenja në trupin e saj dhe fillova ta pyes se çfarë kishte, ajo filloi të qajë dhe më tregoi se interesi për çdo send i humbi, nuk i vjen për të qeshur dhe tha se unë jam i vetmi person që jam duke e mbështetur.

Suksesi në mësimet, si një burim dhe shkak i dhunës fizike dhe psikike ndaj fëmijëve, është theksuar nga disa nxënës, qoftë të fshatit ose të qytetit. Një përshkrim domethënës e jep nxënësja e klasës VI, nga qyteti, i cili rast është i shpeshtë dhe paraqet burim të dhunës.

E di një rast për një shoqe në klasën time. Kur nëna e saj ka ardhur në konsultime me arsimtarët, i kanë treguar që është pak problematike dhe nëna e saj ka dashur të vijë në klasë me rreh, por nuk ka mundur dhe ajo vajza i ka thënë nënës së vet nëse më rreh unë gjuhem prej ballkoni. Ky është sekret që askush nuk e di. Rasti tjetër është kur një vajzë, po ashtu në klasën time, ka marrë një notë të dobët në një lëndë në test dhe kur i ka treguar nënës së saj ajo i ka thënë a nuk po të vjen marre prej meje, sepse jam nxënëse e shkëlqyeshme, pasi ajo i ka dhënë presion, sepse nuk ka pasur kapacitet ma shumë.

Edhe nxënësit e fshatit e trajtojnë çështjen e dhunës si pasojë e suksesit të dobët në shkollë, pastaj në shtëpi u bëhet presion për nota. Një rast të këtillë e përshkruan edhe një nxënëse e klasës VII nga fshati.

“...një shoqe më ka treguar se ka dhunë në familje. Arsyeja e dhunës ishte nota. Ajo e ka suksesin të dobët dhe prindërit e kanë rrahur. Kur ajo më tregoi, u ndjeva shumë keq. Në shkollë ose në mësim më ka ndikuar pak, ngaqë më shkonte mendja në atë rast në mes të mësimin dhe shpesh kisha frikë se mund të më ndodhë edhe mua, por s’dija çka të bëja. Unë, si shoqe, mundohesha ta këshilloja në shumë raste, por ndonjëherë s’dija çka t’i thosha.

Një vajzë e klasës VIII, qytet, tregon për rastin e shoqes së saj, e cila kishte pasur dhunë në familje për shkak të suksesit të dobët në shkollë. Rrëfimi i saj është shumë domethënës, me ngjashmëri të shkakut nga rastet e tjera.

Një rast që më ka treguar një shoqe më kishte brengosur shumë. Ajo ishte abuzuar nga vetë prindi i saj, për shkak të suksesit të ulët. (...) Shoqja ime ka frikë nga prindërit e saj ata kurrë nuk e lejojnë të dalë me shoqe apo shokë, ajo rri vetëm e mbyllur në shtëpi, celularin ia kontrollojnë çdo ditë dhe, sipas mendimit tim, atyre u intereson më shumë për suksesin e shoqes sime sesa për shëndetin e saj mental. Prindërit mund të jenë strikt, por jo deri te pika ku fëmija ka frikë të shkojë në shtëpi për shkak të një note apo një gabimi të vogël! Shoqja ime është shumë vajzë e mirë, mëson dhe ka një edukatë shumë të mirë. Kur vetë prindërit e t’u nuk të besojnë, kush tjetër do të të besojë?

Rasti tjetër që rrëfen një nxënës i klasës IX, fshat, ndërlidhet me presionin që ju bëhet fëmijëve në familje për shkak të notës/suksesit jo ashtu siç e dëshirojnë ata.

...një arsimtar i thotë notën që meriton p.sh. 2 dhe nxënësi i thotë të ia fal një notë më shumë, sepse prindi i ushtron dhunë. Ka filluar të qajë nga frika, nuk ka folur, ndihej shumë keq, por ka ndikuar prindërit e tij, jo që ka kërkuar. Unë jam ndier shumë keq dhe kam kërkuar te arsimtari nëse ka mundësi t’ia rregullojë, sepse ai shoku i klasës filloi të qajë dhe mendova sikur të më kishte ndodhur mua, më pas kam shkuar ta ngushëlloj, por preferonte të mos fliste. Pra,

në asnjë mënyrë dhuna nuk është e mirë në familje, sepse ndikon shumë dhe ka pasoja të gjata mendore.

Rastin se si dhuna në familje reflektohet në sjelljet dhe suksesin e nxënësit në shkollë e përshkruan nxënësja e klasës IX, nga një shkollë në kryeqytet. Ndërlidhja ndërmjet dhunës në familje dhe ndikimi në paraqitjet dhe sjelljet e tij në shkollë janë evidente.

Një rast më ka besuar personi që kishte dhunë në familje. Më shumë kishte dhunë verbale, ku përfshiheshin prindërit dhe vëllai e motra. Si fillim personi ishte i injoruar nga prindërit dhe shumë raste kur vëllai ushtronte dhunë në atë. Në shkollë ishte shumë i hareshëm, kishte shoqëri etj., por një shoqëri të mirë për shkak se frika për me e tradhtuar njerëzit ishte e madhe. Në mësim ishte shumë i dobët, por nuk kam parë person më të zgjuar, qoftë në matematikë apo lëndë të tjera. Frika e madhe se mos gjykohet nga njerëzit e tjerë e ka bërë një person shumë të keq në aspektin se bullizonte të tjerët që ishin më mirë se ai. Këtë e bënte sepse merrte trimëri nga shoqëria e keqe. Pastaj filloi të konsumonte cigare. Mungonte gati çdoherë orët e para të mësimet etj. Kam pasur një shoqëri me të, por nga fjalët e të tjerëve dhe sjelljet e atij personi që reflektoheshin nga prindërit e kam shkëputur çdo komunikim. Jam munduar që t'ia shpjegoj disa gjëra të këqija që bënte, por mënyra se si është rritur dhe edukuar në familje e bën të vështirë përmirësimin.

Rasti në fjalë mund të konsiderohet si një fëmijë i braktisur, i lënë nën mëshirën e rrugës.

Një rast tepër të rëndë e rrëfen një nxënës i klasës IX, nga një shkollë në kryeqytet. Rasti është shumë intrigues për institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Një shoqe e motrës sime ka pasur dhunë në familjen e saj, për shkak të notave, shoqërisë së saj, gjërave private etj. Atë e kanë dënuar, i kanë bërë dhunë fizike, psikike, deri sa e kanë qitur jashtë shtëpisë dhe nuk e kanë lënë të hyjë brenda prej një dite deri në një javë ose

më shumë. Ajo mundohet të përmirësohet, por prindërit e saj ende nuk e shohin. Përpos që ata i bëjnë dhunë asaj, kanë konflikte edhe mes njëri-tjetrit, saqë ka ardhur deri te divorci.

Është një rast i rrallë i përmendur nga nxënësit, për largimin e fëmijës nga shtëpia për shkak të notave, suksesit, dhe të raporteve jo të mira në familje.

13.1.3. Marrëdhëniet jo të mira ndërmjet prindërve

Nxënësjja e klasës VI, qytet, e përshkruan një rast mjaft interesant të shkaqeve të dhunës, por edhe pasojat që kishte ajo dhunë për shoqen e saj. Rasti mund të jetë edhe personal, ngase përshkrimi është shumë i detajuar. Rasti është prishje e marrëdhënieve në familje ndërmjet prindërve dhe pasojat bien mbi fëmijën.

Vitin e kaluar e kam pasur një shoqe e cila ka qenë viktimë e dhunës në familje. Babai i saj përdorte alkool, ndërsa nëna e saj ishte gjithashtu viktimë e dhunës në familje. Shoqes sime shpeshherë i shkonte në mendje që ta paraqiste babin e saj në polici. Ajo ka pasur një ndryshim të madh në shkollë, pasi filloi të mos mësonte si më parë për shkak se prindërit e saj u ndanë. Ajo nuk ishte e lejuar të jetonte me nënën e saj për shkak të kushteve financiare të nënës (ky vendim ishte i gjykatës). Ajo ishte lejuar ta takonte nënën e saj vetëm dy herë në javë (e shtunë, e diel). Por pas një kohe babai i saj u martua me një grua tjetër. Ajo grua, me të cilën babai i shoqes sime u martua, ia ndryshoi jetën babait të saj, sepse pas martesës së dytë babai e la alkoolin dhe nuk ishte më një njeri agresiv e i keq, si më parë. Tani shoqja ime jeton një jetë më të lumtur, sepse gruaja me të cilën babai i saj u martua ishte një grua e mirë, e cila kujdeset për shoqen time. Por, prapëseprapë shoqja ime ndjen mungesën e nënës, mirëpo të paktën nuk jeton më në një ambient ku përdoret dhunë.

Situata e konfliktit ndërmjet partnerëve, prindërve të fëmijëve, janë paraqitur disa herë. Përshkrime të këtilla kemi marrë nga nxënësit pjesëmarrës në pothuajse të gjitha grupet e fokusit. Por, një rast ishte pak më i veçantë, pasi përmendet dhuna në familje në prezencë të fëmijëve.

Të gjithë ishin të mbyllur, prandaj ndodh akti në një familje. Ishte një akt rrëqethës për të gjithë. Gjatë një nate dy bashkëshortë kishin konflikte me njëri-tjetrin, të cilët i kishin 6 fëmijë të moshës së vogël. Burri e kishte rrahur gruan pothuajse për vdekje atë natë. Fëmijët ishin shumë të prekur dhe nuk dinin çfarë të bënin, lotët e tyre rridhnin në faqe. Ajo grua e fortë kishte duruar për shumë kohë, ishte ankuar disa herë, por askush nuk e ndihmoi dhe jeton ende me burrin e saj. Ky rast është për të prekur shumë, sepse jemi në shekullin XXI dhe ende nuk dëgjohet zëri i gruas (vajzë e klasës IX, qytet).

Raste të tilla të dhunës, si pasojë e efekteve negative, të zënkave ndërmjet prindërve, janë deklaruar si ky i nxënës së klasës VII, fshat. Shpesh nuk jemi të vetëdijshëm për efektet. Pasojat i përshkruan kjo nxënëse.

Unë dhe prindërit e mi po shkonim te një i njohur yni dhe rrugës prindërit e mi po diskutonin. Pastaj nisën të grindeshin, sepse ne po shkojmë vetëm te familjarët e nënës sime dhe pse nëna ime nuk donte të shkonte në anën e babait tim. Ata u grindën dhe nuk folën me njëri-tjetrin për 3 ditë. Unë u ndjeva shumë keq dhe po ashtu nisa të qaja çdo natë. Suksesi im më duket që po bie çdo ditë e më shumë. Ata ende grinden ndonjëherë. Dhe unë ende qaj çdo natë. Ndhem sikur do të më braktisin. Këtë s'ia kam treguar askujt.

Ndërsa rasti tjetër, i rrëfyer nga një nxënësi i klasës VII, qytet, tregon gjendjen e shoqes së klasës, e cila i kishte prindërit e ndarë dhe se prindi ushtronte dhunë mbi të.

Në klasën tonë (N.N) i ka prindërit e ndarë dhe prindi i saj i bën presion kur nuk mundet të marrë notën 5, ka dhunë psikike. Më ka ardhur shumë keq dhe i kam afruar mbështetje, ndihmë. Është vajzë shumë e shoqërueshme, por lëndohet shpejt. Mendoj që prindi i saj nuk duhet ta mbyllë me këto fjalë, por t'i japë më shumë mbështetje. Kur merr ndonjë notë ta ndihmojë që ta përmirësojë atë, sepse ajo e ndien edhe mungesën e njërit prind dhe duhet të ketë përkrahjen. Duhet që edhe prindërit ta kuptojnë fëmijën.

Ndjeshmëria e fëmijëve pa njërin prind është e lartë, prandaj nxënësi rrëfyet e ka hetuar mirë këtë gjendje të saj. Nëse ndjeshmërisë i shtohet edhe dhuna, ose presioni për shkak të notës, gjendja vetëm mund të përkeqësohet.

Humbja e interesimit për mësim, frika dhe ankthi janë koncepte të shpeshta në rrëfimet e nxënësve në rastet kur prindërit e fëmijëve kalojnë nëpër probleme të ndryshme si çift. Edhe rrëfimi i nxënësit të klasës VIII, nga shkolla e qytetit, është i kësaj natyre.

Një rast për dhunën ndaj shokut tim, i cili është në klasën e dhjetë. Aty paraqitet një dhunë, përgjithësisht e tërë familja ka pasur konflikte. Nëna dhe babai kanë shkuar tashmë deri te ndarja. Po ashtu, ai ka reaguar keq, sepse është një gjë e cila e mërzit. Ai është sjellë mirë, por është ndier i turpëruar dhe ka humbur pak së interesuari edhe për mësim. As nuk ka kërkuar ndihmë dhe mua më vjen keq për të. Ai po ashtu ka pasojë nga pagjumësia, nga mërzia dhe nga ankthi.

Rastin më të veçantë e rrëfen një nxënës i klasës VIII, me sukses shumë mirë (4), nga një shkollë fshati. Ndër rastet e rralla, ky është tregim i rrëfyer për një përvojë personale dhe është shumë domethënës.

(...) që në moshë të vogël, kur isha vetëm 1 muaj, prindërit e mi u ndanë dhe unë, si i vogël, u mora nga gjyshja ime për të mos përfunduar në ndonjë vend tjetër dhe me kalimin e kohës, tek sa unë po rritesha, babai i dogji të gjitha fotot dhe gjërat që unë të mos i

shihja. Mua fshehtas gjyshja m'i tregonte disa gjëra dhe unë një ditë prej ditësh, papritur mora guximin që t'i thosha që unë doja ta takoja edhe mamin tim, sepse nuk e kisha parë asnjëherë dhe ajo ishte përgjigjja më e keqe që unë e mora. Si pasojë shkoi deri te rrahja, kur babai më rrihte sa herë që unë e përmendja ose e thosha. Kështu që çdoherë e përsëri goditem nga ai në mënyra të ndryshme, por unë po jetoj me shpresën se një ditë do ta takoj atë dhe do të jem i lumtur me të dy.

Rrëfimi është unik nga të gjitha rrëfimet e bëra dhe të përshkruara nga ana e nxënësve të shkollave të ndryshme.

13.1.4. Sjelljet abuzive si pasojë e traditës dhe gjendjes ekonomike

Edhe elementi i varfërisë mund të bëhet shkak/burim i dhunës dhe sjelljes jo të mirë të nxënësve. Një rrëfim të tillë e bën njëra nga nxënëset e klasës IX, nga një shkollë fshati.

... është një shoqe jona, e cila nuk i ka kushtet e mira. Ajo fshehurazi na i merr gjërat nëpër klasë, por nuk tregon. Një ditë e kam parë prindin e saj duke i marrë një parë patika për djalin e saj te një shtëpi, pastaj mendoj se si prindi dhe fëmija jo vetëm kjo, por edhe nuk e lejojnë të vijë me ne. Po ashtu, i thonë të gënjejë, mos të tregojë të vërtetën. Mua kjo më duket dhunë, sepse nuk më duket një gjë e mirë ta mësoj fëmijën të gënjej, të marrë gjëra në klasë pa dijen tonë dhe si e shoh nuk kujdesen mirë për të.

Përdorimi i mjeteve të teknologjisë si shkak për mospajtimet prindër-fëmijë, dita ditës, po zë vend domethënës në shoqërinë tonë. Një rast të tillë e përshkruan nxënësja e klasës VI, nga qyteti.

Në shoqërinë time kam shumë raste që kanë dhunë në familje, por njëra prej tyre është për një vajzë 14-vjeçare, e cila më ka prekur

shumë emocionalisht. Dhuna ndaj saj është përdorur për shkak të përdorimit të shumtë të rrjeteve sociale dhe mosmësimimit në shkollë. Tek ajo ka ndikuar dhuna psikikisht dhe fizikisht, ka bërë që të largohet nga shoqëria e saj dhe është mbyllur si person, nuk ka folur me ta, është person i vetmuar dhe ka ndikuar shumë keq tek ajo. Ajo ma kërkoi ndihmën time, që të qëndrojë tek unë disa ditë, sepse ajo ishte e dhunuar fizikisht me ditë të tëra nga prindërit e saj dhe po e dëmton atë si vajzë shumë rëndë. Ajo po ashtu është tërhequr edhe më shumë prej mësimeve. Dhe, për në fund, kam një këshillë për të gjithë: stop dhunës, sidomos ndaj fëmijëve, sepse tek ata do të ndikojë dhuna keq dhe do të bjerë punën deri në atë pikë që mos të duaj veten e vet ai person.

Në familjet e mëdha, të përbashkëta, zakonisht dikush “sundon”, prandaj e merr edhe të drejtën e disiplinimit të fëmijëve, edhe me anë të dhunës fizike. Një rast të këtillë e përshkruan një nxënëse e klasës IX, në fshat.

...kam dëgjuar nga të afërmit e mi për një rast. Si çdo fëmijë që pëlqen lojën ku ka fshatar edhe një djalë i vogël e pëlqente. Një natë ai u fsheh dhe nuk u tregoi familjes së tij se ç'po bënte. Të gjithë u merakosen dhe e kërkonin. Kur motra e tij e gjeti atë, u mundua ta arsyetonte para të tjerëve, sepse axha i tij do ta rrihte sepse ai ishte fshehur dhe i kishte merakosur dhe kjo gjë ndodhi. Ishte e tmerrshme vetëm për ta menduar se si familjarët e tjerë u munduan ta qetësonin dhe të mos e rrihte, por ai e bëri të veten. Unë vetëm e dëgjoja këtë ngjarje dhe ndihesha e tmerruar. Ai fëmijë nuk besoj se do të jetë në gjendje të bëjë asgjë pa lejen e ndokujt, sepse ndihej gjithmonë i frikësuar.

Dhuna e shprehur në familje ndaj nxënësve nuk vjen vetëm nga prindërit, por edhe nga anëtarët e tjerë të familjes. Rasti në vazhdim, i rrëfyer nga një nxënëse e klasës VII, qytet, tregon situatën kur dhuna ushtrohet nga vëllai i madh.

Rasti që kam ndërmend të ndaj me ju është nga një shok që ka përjetuar një dhunë të madhe fizike e psikologjike. Ky thuhet se përjetoi këtë dhunë nga nxënësit e shkollës e dhunën fizike nga vëllai i madh i tij. Pas ca kohësh, reagimi i tij ishte tronditës, por edhe shumë i nevrikosur. U sillte mirë me mua për shkak se i nevojitej një mik afër vetes. U ankonte shumë. Ankimi më i madh ishte ta ndërronte shkollën e të mos fliste me vëllain e tij. Diçka që mund të shtoj në fund është se ai kërkoi edhe ndihmën time dhe të njerëzve që i afroreshin për të marrë hakun që bënë ata ndaj tij.

Nxënësi i klasës VIII (fshat) rrëfen për dhunën që ka përjetuar i vëllai nga anëtarët e familjes dhe se si është ndier dhe në çfarë gjendje ka qenë. Ai rrëfen edhe për përjetimin e tij, si dëshmitar i situatës në familje.

“... vëllai im i madh ka qenë viktimë e kësaj dhune. Edhe pse nuk ka qenë dhunë e rëndë, prapëseprapë ka qenë një eksperiencë tepër e dhimbshme. Në shumë raste vëllai ka pasur një hidhërim me familjen për disa orë. Gjatë asaj kohe, ai ankohej se ndihej shumë keq dhe i diskriminuar nga pjesa tjetër e familjes. Nuk fliste me askënd dhe qëndronte vetëm dhe pa bërë zë derisa e merrte veten prapë. Këto raste nuk kanë ndodhur më që disa kohë dhe shpresoj të mos ndodhin më as në familjen time, e as në shoqërinë ku jetojmë.

Edhe detyrimi për të punuar paraqet një version të veçantë të dhunës ndaj fëmijës. Rasti që rrëfen nxënësi i klasës VII, qytet, është interesant, pasi që prindi nuk është i kënaqur me fitimin.

Unë e njoh një fëmijë që ka pasur një dhunë fizike dhe psikologjike, që ka qenë i detyruar të shkojë të shesë cigare gjatë gjithë ditës dhe në fund, kur ia jepte paret, babai nuk ishte i kënaqur dhe bënte dhunë fizike te djali, po ashtu edhe dhunë psikologjike. Tash ai djalë është shpresëhumbur nga familja e tij.

Nxënësi i klasës VII, qytet, rrëfen për shokun e shkollës, i cili përjetonte dhunë për shkaqe të papunësisë së prindit dhe konfliktit ndërmjet prindërve. Ai e përshkruan kështu rastin e tij.

Shoku që e kam pasur në lagje ka pasur dhunë konstante nga familja, atë nuk e kam parë që nga viti 2016, sepse ka migruar bashkë me nënën dhe motrën e tij në (...). Ishte djalë i shkëlqyer në shkollë dhe shumë besnik. Kishte raste kur e shihja të lënduar dhe të mërzitur, por kishte edhe raste kur nuk e shihja në lagje fare për 2-3 ditë. Babai i tij ishte ndarë me nënën, por jetonin bashkë, sepse nuk kishin të holla të mjaftueshme që të blinin një vendbanim (apartament). Babai i tyre ishte i papunësuar dhe shumë person i keq, gjithmonë rrinte i pirë dhe e dhunonte fizikisht të birin. Pastaj erdhi një kohë kur ai ra shumë me nota dhe niveli emocional ishte 0. Po ashtu, qëndronte në një formë depresioni.

Patëm edhe raste të tjera, kur kërkesa për mbikëqyrje të rreptë të fëmijëve, e sidomos vajzave, kishte kaluar në formë të dhunës ndaj tyre.

Unë e kam një shoqe që jeton në lagjen time dhe një ditë kam shkuar tek shtëpia e saj. Para se të hyj, kam dëgjuar babanë e saj duke i bërtitur nënës së saj dhe jam shokuar, sepse gjithmonë më është dukur si një familje e lumtur dhe ajo menjëherë më ka thënë që të dalim jashtë më mirë dhe jam munduar që të flas me të dhe të hapet me mua, sepse do të ndihej pak më mirë. Sa herë kam dalë me të babai i saj e thërriste vazhdimisht dhe i bërtiste që të kthehej në shtëpi. Për sa i përket dhunës fizike, nuk e kam parë që i ka ushtruar, por gjithsesi dhuna verbale ndikonte shumë keq në mendjen e saj, sepse çdo ditë shkante dhe u bënte shumë e mbyllur në vete, edhe pse mundohesha që të flisja me të për problemet e saj dhe më tregonte se babai i saj ishte një njeriu shumë i rreptë dhe sa herë ishte i mllefosur me vete ua linte fajin familjarëve. Edhe pse unë me këtë shoqe nuk dal më, sepse ajo është distancuar pasi që babai nuk e linte të rrinte me askënd. Gjithsesi, unë shkruaj në rrjete sociale me

të dhe më tregon se çfarë ndodh, por ditët e fundit babai ia ka marrë telefonin dhe unë nuk kam më kontakt me të dhe nuk e shoh më. Por, kam dëgjuar nga shoqet e tjera se babai i saj ka shkuar jashtë shtetit dhe jam ndier shumë mirë.

Edhe rastet e familjeve ku kërkohet një lloj perfeksioni fëmijët janë viktimë e dhunës, për shkak të prishjes së vijave që ka vendosur familja. Një rast të tillë e rrëfen nxënësjja e klasës IX, qytet.

Familja e saj kujdesej për të si çdo familje tjetër, por normal ishte edhe ajo ana negative, sepse asgjë nuk është e përkryer, por kjo ishte më keq. Ajo ishte një vajzë me nota të shkëlqyeshme dhe e sjellshme. Nga jashtë, para se ta njohja, mua më dukej se ishte gjithçka në rregull, por kur u afruam më shumë, ajo u shpreh lirshëm me mua. Në familjen e saj ishte e pranishme dhuna dhe ajo më tregonte se sa herë që ndodhte një problem apo bënte ndonjë gabim, ose suksesin nuk e kishte sa duhej, familja i ushtronte dhunë fizike, por edhe psikologjike. Kur flisja me të, qante kur më tregonte dhe thoshte që është e vë për të dhe se ndonjëherë do të mos kthehet as në shtëpi. Interesi për mësim i kishte humbur, por ende disi ia dilte të merrte nota. Ndihmën time nuk e kërkoi, por donte që vetëm ta kishte dikë pranë saj, me të cilin të jetë e lirë të bisedojë për problemet që kishte.

13.1.5. Abuzimi me alkool nga prindi (babai)

Nxënësit në rrëfimet e tyre kanë prezantuar raste të shumta të fëmijëve të cilët kanë qenë objekt i dhunës. Përjetimet e tyre, siç janë raportuar, lënë pasojat në të ardhmen. Përshkrimet e shkaqeve dhe pasojave, si dhe situatave të dhunës në familje, të cilat paraqiten si rezultat i abuzimit me alkool nga ana e prindërve, janë të shumta. Veprimet e dhunshme të prindit, babait ndaj nënës dhe fëmijëve, janë përshkruar në disa raste.

Rasti ka të bëjë me dhunë në familje. Të dy prindërit kanë pasur probleme bashkëshortore, kanë pasur edhe katër fëmijë dhe fëmija më i madh ka qenë nxënës shumë i dalluar në shkollë dhe atë vit do të mbahej testi i arritshmërisë. Kishte shumë kohë që nxënësi vinte ndonjëherë i papërgatitur në shkollë dhe arsimtarët habiteshin nga gjestet e tij. Dhuna indirekte që ai kishte përjetuar kishte ndikuar në të gjitha aspektet, si në mësim, në sjellje dhe gjëra të tjera. Në fillim nxënësi ishte shumë i qetë, nuk bisedonte me askënd, nuk përsëriste asgjë, pastaj me shtimin e dhunës sjelljet e tij ndryshuan. Ai nuk u ankua askund, ndoshta edhe prej presionit që i është bërë në shtëpi. Çdo përlëshje që ndodhte në shkollë apo kudo tjetër ai reagoonte në një formë të papritur, ndoshta e ndiente se si ndihej ai. Pastaj shokët dhe shoqet e klasës së tij e bënë që person të hapej dhe të tregonte tmerrin të cilin ai e kishte përjetuar, babai duke e rrahur mamanë e shpeshherë edhe fëmijët, për arsye se babai nuk sillte të ardhura në shtëpi dhe fëmijët duhet të visheshin të mbatheshin të ushqeheshin, të mirëmbaheshin , sepse vinte kohët e fundit edhe i dehur (vajzë e klasës IX, qytet).

Përshkrim të zgjeruar dhe domethënës bën një rast i një nxënësi të klasës IX, qytet. Përshkrimi është shumë indikativ dhe përfshin shumë faktorë dhe shkaqe të dhunës, përfshirë edhe abuzimin me alkool, si dhe pasojat e kësaj situate te prindërit dhe familja në përgjithësi.

Njoh një person [nxënës], i cili ka përjetuar dhunën në familje, jo vetëm verbale, por edhe fizike. Nga e kaluara, prindi i personit në fjalë ka pasur probleme financiare dhe ka filluar më vonë të përdorë alkoolin. Ai është bërë i varur nga alkooli dhe ka filluar të ndryshojë sjelljen me të gjithë anëtarët. Dhuna që miku im ka kaluar e ka bërë që të humbasë motivin në mësim, aktivitete dhe gjëra të tjera në përgjithësi. Pastaj filloi të konsumojë duhanin, notat e tij zbriteshin çdoherë e më shumë, nuk vjen shpesh në shkollë ose ikën nga orët. Kur vërejta këto ndryshime, fillova ta pyes se çfarë po ndodhte. Më

tha se është lodhur nga të gjithë. Kjo ngjarje po vazhdonte në familjen e tij, prindërit e tij ishin ndarë dhe ky kujdesej për vëllezërit më të vegjël. Unë u mundova që ta ndiejë një siguri tek unë dhe të më tregojë apo të flasë me mua çdoherë që dëshironte. Ai filloi të përmirësohej. Pas një viti, ai ishte më i sigurt që mund të bënte diçka dhe ta parandalojë sadopak që mundet këtë rast. Ndaloj cigaren, problemet në shkollë, dhe tani është i fokusuar në krijimin e një karriere të mirë e të pastër dhe ta mbarojë shkollën. Prindërit e tij e kanë gjetur atë paqen apo stabilitetin që duhet të kenë. Jam shumë krenare që ka arritur ta kalojë këtë gjë.

Për rastet e dhunës fizike dhe formave të tjera të dhunës, për shkak të çrregullimeve në familje, si pasojë e abuzimit të prindit me alkool, rrëfen edhe nxënësja tjetër e klasës VII, nga një shkollë e qytetit.

Unë e kam pasur një mike të lagjes dhe ajo më tregonte se prindërit e saj kishin mosmarrëveshje dhe grindeshin mes tyre. Kjo ishte për shkak se babai përdorte alkoolin dhe ushtronte dhunë psikologjike dhe fizike ndaj nënës së saj dhe mikes sime. Ajo kishte shenja në duar dhe ndikonte shumë keq në zhvillimin e mësimave dhe për këtë arsye ra në nota të dobëta dhe filloi të bëhej agresive dhe një ditë nuk më fliste. Kështu u bënë javë që s' më fliste dhe unë e pyeta pse nuk më flet, pasi nuk i bëra asgjë. Ajo nuk m'u përgjigj dhe u largua. Filloi të shkonte rrugëve të këqija, e cila u bë shkak i divorcit të prindërve të saj. Pas kësaj, ne nuk flasim me njëra-tjetrën dhe s'di se çka ka ndodhur me të.

Tregime afërsisht të ngjashme, për rastet e abuzimit të prindërve me alkool, janë identifikuar në shumë rrëfime nga nxënës të klasave dhe të shkollave të ndryshme. Përshkrimet dhe rrëfimet janë të llojllojshme. Një nxënëse e klasës VIII, nga një shkollë fshati, ka një rrëfim të veçantë për dhunën në familje, gjendjen e shoqes, por edhe ndihmën e ofruar pasi që nëna dhe vajza (shoqja) kishin përjetuar dhunë në familje.

(...) një shoqe imja ka pasur dhunë në familjen e saj dhe më ka treguar vetëm mua. Nuk ka pasur dhunë fizike, por psikologjike. Unë e kisha kuptuar para disa muajsh sepse kishte humbur interes në aktivitete në mësim, kishte rënë nga pesha, kishte humbur shumë peshë, sillej ndryshe në shumë raste me mua, por pasi mora vesh situatën u ndjeva shumë keq dhe i qëndroja afër gjatë gjithë kohës dhe sa herë që kishte nevojë për mua, i lija të gjitha punët dhe i gjendesha afër. Problemi ishte se babai i saj dehej aq shumë sa që kur shkante në shtëpi, përdorte dhunë psikologjike ndaj tyre dhe ato fjalë e bënë që të ndihej keq dhe të mos kishte besim në veten e saj. Por, ajo bashkë me nënën e saj morën një vendim, që të ndaheshin nga babai i saj dhe të largoheshin nga ai ambient, pasi që çdo gjë mbaroi. Nëna dhe vajza, shoqja ime, d.m.th. unë dhe familja ime i bindëm që të shkonin te një psikolog, sepse menduam se do t'i bënte mirë të dyjave dhe ashtu ndodhi. Gjithçka është në rregull tani.


Alkooli dhe problemet e tjera sociale rrëfohen për të satën herë si burim kryesor i dhunës në familje. Një rast shumë domethënës e përshkruan nxënësi i klasës VIII, qytet.

Kam pasur një mik që e ka ndaluar shkollën për disa javë. Kur u kthye, nuk fliste me askënd, për asgjë. Vetëm mua më ka treguar që prindi i tij kishte pirë shumë alkool. Ai i kishte mbyllur në shtëpi dhe i kishte rrahur familjarët. Nuk i kishte lënë të dalin nga shtëpia deri ditën që ka ardhur në shkollë. Askush tjetër nuk e di, përveç meje. Ka kaluar kohë që s'e kam parë atë më. Na kanë thanë se e ka ndërruar shkollën, por s'dimë gjë tani për të.

Përshkrimi është interesant, ngase shihet se edhe rrëfyesi e ka përjetuar rëndë rastin e shokut, si viktimë e dhunës.


13.2. Gjetjet kryesore nga grupet e fokusit

Në intervistat dhe diskutimet në grupet e fokusit, nxënësit, të ndarë në grupe me nga 4-5 nxënës, i kanë identifikuar shkaqet e mundshme, ose shkaqet për të cilat ata kanë njohuri, të ushtrimit të dhunës ndaj nxënësve nga anëtarët e familjes. Është me interes të theksohet se shkaqet, apo faktorët, që nxisin dhunën në familje, janë afërsisht ata që janë identifikuar edhe përmes shqyrtimit të literaturës. Për ilustrim të shkaqeve dhe pasojave të dhunës, sipas mendimit të nxënësve të njërit grup fokusi, është përgatitur grafiku 1, në vazhdim.




Grafiku 1. Kështu i shohin shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj fëmijëve në familje nxënësit e një shkolle në fshat.

Nxënësit e po të njëjtës shkollë, por në grup tjetër, kështu i paraqitën shkaqet dhe pasojat e prezencës së dhunës ndaj fëmijëve në familje.




Grafiku 2. Shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje, sipas grupit të dytë të nxënësve.

Nxënësit e kësaj shkolle, në fshat, kanë identifikuar nga tre faktorë/shkaqe kryesore të prezencës së dhunës në familje, ku viktimë janë fëmijët. Derisa nxënësit e grupit të parë si burim për prezencën e dhunës në familje i shohin: mosbindjen e fëmijëve ndaj prindërve, gjendjen jo të mirë ekonomike dhe sociale, si dhe përdorimin e alkoolit, grupi i dytë i nxënësve mendojnë se janë problemet familjare, problemet apo sjelljet e nxënësve, si dhe përdorimi i lëndëve narkotike. Të dyja grupet i kanë identifikuar edhe pasojat që vijnë si rezultat i dhunës së përjetuar nga nxënësit.



Grafiku 3. Shkaqet dhe pasojat e dhunës sipas nxënësve të një shkolle në qytet.

Ky grup i nxënësve si burim të dhunës ndaj nxënësve e shohin edhe mungesën e komunikimit me prindër, por edhe pikëpamjet, apo qëndrimet e mësimdhënësve ndaj nxënësve, të cilat ua transmetojnë prindërve. Po ashtu, edhe presionin ose kërkesat e larta dhe pritjet e prindërve ndaj fëmijëve për arritje të suksesit në shkollë, si burim/shkak i ushtrimit të dhunës ndaj tyre, goftë fizike ose edhe verbale.



Grafiku 4. Identifikimi domethënës i shkaqeve dhe i pasojave të dhunës në familje

Grupi i katërt i nxënësve i kanë identifikuar problemet mendore, gjininë e fëmijës, rastet e xhelozisë dhe tradhtisë ndërmjet çifteve, si dhe superioritetin e burrave, si shkaqe kryesore të dhunës. Grupi mendon se pasojat nga këto veprime shfaqen përmes humbjes së motivimit për punë të fëmijëve, gjendjes së rënduar emocionale të përcjellë me ankth dhe stres, si dhe frika e vazhdueshme se dhuna mund të përsëritet në familje.

14. Diskutimi

Hulumtimi trajtoi 5 pyetje kryesore:

1. *A ushtrohet dhunë në familje ndaj nxënësve? Cili lloj i dhunës, nëse ka, është më i shpeshti?*
2. *Si e perceptojnë nxënësit dhunën ndaj tyre ose shokëve/qeve të tyre në familje?*
3. *Si e përjetojnë nxënësit dhunën fizike dhe verbale ndaj tyre në familje?*
4. *Cilat janë shkaqet dhe pasojat e prezencës së dhunës për fëmijët sipas perceptimit të nxënësve?*
5. *Cili është roli i mekanizmave kundër dhunës për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna?*

Pyetjet 1 deri 4 janë trajtuar të integruara, përmes rrëfimeve individuale të nxënësve, me pyetjen kryesore për nxënësit: A mund të përshkruani ndonjë rast që dini për dhunën ndaj shokut/qes që i ka ndodhur në familje ndaj tij/saj? Ndërsa diskutimi i moderuar në grupe fokusi ofroi mundësi për identifikimin e shkaqeve dhe pasojave të dhunës së përjetuar nga nxënësit. Sa i përket pyetjes së pestë, lidhur me rolin e mekanizmave përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, të dhënat u grumbulluan përmes intervistave me aktorët relevantë, si dhe literaturës aktuale.

Bazuar në të dhënat nga studimi, është me rëndësi diskutimi i tyre në raport me shkaqet dhe pasojat e dhunës, si dhe ndikimi i dhunës në shëndetin mendor të fëmijëve. Këto tri aspekte janë analizuar duke i krahasuar dhe plotësuar edhe me literaturën relevante.

14.1. Faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në prezencën e dhunës në familje

Në punën me grupet është kërkuar nga nxënësit që t'i identifikojnë faktorët ose shkaktarët kryesorë të prezencës/ushtimit të dhunës ndaj nxënësve në familje. Siç shihet në listën e shkaqeve, ose të faktorëve të shprehur nga ana e nxënësve, më shumë janë përmendur: xhelozia ndërmjet partnerëve, problemet ose gjendja jo e mirë ekonomike dhe sociale e familjes, divorci, varfëria, komunikimi jo i duhur dhe jo i rregullt ndërmjet anëtarëve të familjes, sidomos ndërmjet bashkëshortëve pastaj edhe ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Po ashtu, përdorimi i mjeteve abuzive ose edhe i drogave, lojërat e fatit, alkoolizmi, sjelljet e fëmijëve, kërkesat e larta të prindërve për nota më të larta, problemet shëndetësore/mendore të prindërve, sidomos të babait, niveli i ulët i edukimit të familjes, ngarkesat/depresioni nga puna, tradhtia ndërmjet bashkëshortëve, mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërmjet anëtarëve të familjes etj.

Është me rëndësi të theksohet se nxënësit si shkaqe, ose burim i dhunës në familjes ndaj nxënësve, apo si përjetues të dhunës së tërthortë, i kanë identifikuar shumicën e atyre që veç dihen nga raportet e organeve policore e gjyqësore. Ndër shkaqet që nxënësit nuk i kanë theksuar/cekur, por që gjendet në një opinion të Institucionit të Avokatit të Popullit – IAP (2016), është neglizhenca (moskujdesi i duhur, moskokëçarja) nga ana e prindërve ndaj fëmijëve. Në këtë aspekt, sipas opinionit të IAP:

Neglizhenca i referohet dështimit të prindit apo kujdestarit përgjegjës për të siguruar një zhvillim të mirëfilltë të fëmijës. Pra, kur fëmija vuan ndikimin e mungesave apo mangësive të kujdesit,

që lidhen me nevojat elementare, si: ushqimi, strehimi i sigurt, kushtet, kujdesi shëndetësor, edukimi, mungesa e dashurisë.

(IAP, 2016, p. f.).

Rrëfimi i këtij nxënësi paraqet një rast të neglizhencës së prindërve dhe familjes ndaj tij.




Foto 1: Rrëfimi individual i rastit të neglizhencës nga ana e prindërve

Disa grupe fëmijësh kanë cekur një element të neglizhencës që ata e emërtojnë si “mosedukatë” ose edukim i pamjaftueshëm i prindërve për t’u marrë me edukimin e fëmijëve. Gjithashtu, në zhargonin e koncepteve dhe shprehjeve të përfshira në shkaqet e dhunës në familje nxënësit kanë

përmendur edhe gjendjen e prindërve për shkak të gjendjes materiale dhe sociale të tyre. Si element të dhunës, sidomos asaj psikike ndaj tyre, i shohin sjelljen agresive, fjalosjen, ngritjen e zërit ndaj anëtarëve të tjerë.

Pasqyrimi më i qartë i shkaqeve, burimit të dhunës në familje ndaj nxënësve, nxënësit e kanë paraqitur gjatë punës në grupe. Ata së pari i kanë diskutuar shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje ndaj fëmijëve, pastaj i kanë paraqitur në formë të trungut të problemeve, ose si tufë mendimesh.




Foto 2 Shkaqet dhe pasojat e dhunës

Është shqetësues fakti se në disa raste, si në rrëfime ashtu dhe në fokus-grup, si pasojë të dhunës përmendin vetëvrasjen. Po ashtu, shqetësues është edhe një shkak tjetër i dhunës që identifikohet nga fëmijët pjesëmarrës në këtë studim – gjinia e fëmijës së lindur. Dhuna në këto raste është e shprehur sidomos nëse fëmija i lindur është vajzë, ndërsa pritet dhe dëshira kanë qenë

të jetë djalë. Gjithashtu, përdorimi i shprehjes “i rënduar emocionalisht” është një përshkrim shumë i saktë i gjendjes së individit pas përjetimit të dhunës. Ndërsa një element tejet me rëndësi për t’u përmendur është se ky grup deklaroi që “fëmijët mund të trashëgojnë abuzimin që e kanë parë”, që do të thotë se mund të mësohen me dhunën rreth tyre dhe ta përsërisin ndaj të tjerëve kur të rriten, të bëhen prindër ose bashkëshortë.

Sipas një studimi të Qeverisë së Australisë (Kaspiew et al, 2017), dhuna në familje ka ndikim negativ në shëndetin mendor të fëmijëve. Ky ndikim është identifikuar edhe në studimin e Rattanavicha et al, (2021). Sipas të njëjtit burim, fëmijët vazhdimisht ndihen të pasigurt në shtëpinë e tyre, duke përfshirë edhe prindërit (ibid, f. 692). Konstatimet e nxënësve janë në linjë me studimin e Rattanavicha et al. (2021), pasi që edhe këta kanë identifikuar afërsisht të njëjtat gjendje psikike të fëmijëve që kanë përjetuar dhunë në familje.

Gati në linjë me faktorët e dhunës në familje, të identifikuar nga ana e nxënësve, janë edhe autorët Islam Krasniqi & Afërdita Deva- Zuna (2012). Në kuadër të faktorëve që ndikojnë në ushtrimin e dhunës, prezencës së saj në familje, këta autorë i listojnë: martesat e parakohshme, shkeljet e rregullave nga fëmijët të vendosura nga prindërit dhe mospërbushjen e tyre nga fëmijët (*nxënësi e quajnë si mosbindje ndaj prindërve*), përkëdheljen dhe mbikëqyrjen tej mase të tyre, shkallën e ulët e arsimimit të prindërve, punësimin e prindërve, sjelljet e dhunshme të fëmijëve, kërkesat e tepruara ndaj fëmijëve etj. (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012, f. 285-288). Në analizën e thelluar që i bëjnë dukurisë së dhunës në shkollë, këta autorë si mundësi të parandalimit të saj e shohin këshillimin pedagogjik, këshillimin e familjes, duke identifikuar faktorët parandalues para se të ndodhë dhuna në familje (Krasniqi & Deva-Zuna, 2012, f. 283).

Shkaqet e prezencës apo shfaqjes së dhunës në familje, sipas Deva - Zuna (2008), janë “çështje të strukturës së personalitetit [...] edukimi familjar, kulturës së komunitetit dhe shoqërisë në të cilën formohet personaliteti” i pjesëtarëve të familjes (Deva –Zuna, 2008, f. 7). E njëjta autore faktorët që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në familje i ndan në të përgjithshëm:

mentalitetit fanatic, komunikimi i dhunshëm në familje, krijimi i dallimit mes djemve dhe vajzave nga prindërit, paragjykimi gjinor, pastaj statusi social-ekonomik, papunësia e gruas, shkalla e arsimit...(ibid, f. 7). Tërthorazi edhe këtë element të shkaktarit të dhunës në familje e kanë cekur nxënësit, qoftë në rrëfimet ose në paraqitjen grafike të tyre në grupe të fokusit.

14.2. Pasojat e dhunës në familje, të adresuara nga nxënësit

Nxënësit e të gjitha klasave dhe shkollave kanë listuar një gamë të gjerë të pasojave që mund të derivojnë nga nënshtrimi i dhunës, qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthorët, si nga dhuna fizike ashtu edhe nga format e tjera të dhunës. Këtë e kanë argumentuar të gjitha studimet dhe trajtesat e bëra nga institucione dhe autorë të shumtë. Përveç humbjes së vetëbesimit, perspektivës, si pasojë e dhunës në familje ndaj nxënësve, në rrëfimet e tyre, si dhe në grafikun e pasojave, kanë përmendur edhe mundësinë e aktit të skajshëm të vetëvrasjes.

“Dhuna shkakton çrregullime dhe prek të gjitha nivelet e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, sferat emocionale, njohëse dhe sjelljen. Për më tepër, fëmijët përballen me rreziqe më të larta për sa u përket shëndetit fizik dhe çështjeve arsimore në të ardhmen. Gjithashtu, fëmijët e përshkruajnë dhunën në familje si një përvojë të ndërlikuar, izoluese dhe afatgjatë, e cila çon në shkatërrim dhe probleme në marrëdhëniet e tyre (Rattanavicha et al., 2021, f. 693).

14.3. Mendimet e nxënësve për ndikimin e dhunës në shëndetin mendor

Pasojat e dhunës në familje që nxënësit i kanë identifikuar, por edhe përshkruar, në rrëfimet e veta janë thuajse të përafërta me studimet e bëra për këtë dukuri negative të shoqërisë. Në studimin e tyre, Rattanavicha et al.

(2021), përveçqë ndihen të pasigurt në shtëpi, gjithashtu kjo çon edhe kah ndjenja e frikës, por edhe e turp-it për t'u rrëfyer të tjerëve. Pasojat psikologjike për fëmijët, të cilët i janë nënshtruar/eksponuar dhunës, ose kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të saj, shfaqen në formë të traumës, ndikojnë në pagjumësi, apetit dhe përqendrim në mësim (Rattana-vicha et al., 2021, f. 692).

Sipas një studimi të bërë nga Royal College of Psychiatrists (2015), del se ka një dallim ndërmjet djemve dhe vajzave sa i përket përjetimit të dhunës në familje. Kështu, sipas këtij studimi, thuhet se djemtë duket se kanë filluar të përdorin mënyra të zakonshme për të bllokuar përvojat dhe kujtimet shqetësuese. Vajzat ka të ngjarë të mbajnë shqetësimin e tyre brenda, të bien në depresion dhe të mendojnë keq për veten e tyre (sipas Rattana-vicha et al., 2021, f. 693). Në studimin për dukurinë e dhunës në vende të ndryshme një studim i OKB-së (Office of the Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children, 2020) ka paraqitur skemën e efektit të dhunës ndaj fëmijëve, në të cilën shihet efekti i dhunës ndaj fëmijës në shëndetin mendor të tij. Edhe nxënësit kosovarë të përfshirë në mostrën e studimit thuajse i kanë identifikuar të gjithë pasojat e dhunës. Në fazën e përbrendësimit të këtij efekti shihen konceptet, të cilat janë përmendur nga nxënësit, si: ankthi, trauma, depresioni etj.

14.4. Ndikimi i dhunës në familje në shëndetin mendor të fëmijëve

Të gjitha studimet argumentojnë se dhuna ndikon, përveç tjerash, në shëndetin mendor të fëmijëve. Shëndeti mendor është pjesë përbërëse e shëndetit të përgjithshëm të individit. Sipas OBSH-së, shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale, dhe jo thjesht mungesë e sëmundjes ose dobësisë (sipas Office of the Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children, 2020, f. 1). Një në katër fëmijë nën moshën pesë vjeç jeton me një nënë që është viktimë e partnerit intim - dhunës (po aty, 2020, f. 3).

Në një studim të bërë lidhur me ndikimin e dhunës dhe të abuzimit të fëmijëve në familje konstatohet se:

“...të rinjtë e ekspozuar dyfish ndaj abuzimit dhe dhunës në familje ishin më pak të lidhur me prindërit në adoleshencë sesa ata që nuk u ekspozuan, ata që vetëm u abuzuan dhe ata që u ekspozuan vetëm ndaj dhunës në familje. Marrëdhënia midis llojeve të ekspozimit dhe rezultateve të të rinjve nuk ndryshonte, sipas nivelit të lidhjes me prindërit”. (Sousa, Herrenkohl et al. 2011, f.1)

Kjo paraqet një shqetësim për shëndetin mendor të të rinjve në veçanti, si dhe qytetarëve në përgjithësi.

Ndikimi në zbehjen, ose edhe shkëputjen e lidhjes prindër-fëmijë mund të paraqesë shqetësime, por edhe probleme për komunitetin përreth. Siç konstatojnë Pattanavich et al. (2015), mungesa e ngrohtësisë në familje ndaj fëmijës ndikon që ai të bëhet shqetësim për fqinjët dhe mund të shkaktojë probleme në komunitetin që e rrethon (ibid, f. 695). Gjithashtu, sipas rezultateve të të njëjtit hulumtim, “...dhuna në familje ndikon në agresivitetin e fëmijëve” (ibidem, f. 695).

Pasojat e dhunës te të miturit janë shkatërruese dhe ndikimi në shëndetin e tyre mendor, për shkak të moshës dhe momentit evolucionar në të cilin ndodh kjo dhunë, lë pasojat në disa nivele, pavarësisht nëse ato janë objekt i saj apo nëse janë dëshmitarë të dhunës në familje (Galderisi, S., Heinz, A. et al., 2015). Në nivelin fizik shfaqen vështirësi në zhvillim dhe në rritje, probleme në lidhje me gjumin dhe urinë, dhimbje koke, dhimbje stomaku etj. Gjithashtu, plagë dhe lëndime në rast se janë objekt i drejtpërdrejtë i dhunës. Në një nivel emocional, identifikohen ankthi dhe depresioni, problemet e vetë vlerësimit, stresi post-traumatik ose shqetësimi i ndarjes nga anëtarët e tjerë të familjes. Në një nivel njohës, paraqiten vështirësitë e të mësuarit dhe përqendrimit, performanca e dobët në shkollë dhe vështirësia

më e madhe në zhvillimin verbal dhe të përgjithshëm. Në nivelin e sjelljes, ndikojnë në zhvillimin e sjelljeve antisociale dhe agresive, ndërsa në adoleshencë mbizotërojnë sjelljet kriminale, alkooli dhe abuzimi i substancave të tjera, si dhe sjelljet vetëshkatërruese.

Shëndeti mendor është një gjendje dinamike e *ekuilibrit të brendshëm*, që u mundëson individëve të përdorin aftësitë e tyre në harmoni me vlerat universale të shoqërisë. Aftësitë themelore njohëse dhe sociale; aftësia për të njohur, shprehur dhe modifikuar emocionet e veta, si dhe për të *bashkëndier* me të tjerët; *fleksibilitet* dhe aftësi për të *përballuar ngjarjet negative të jetës* dhe për të funksionuar në role sociale; dhe marrëdhëniet harmonike ndërmjet trupit dhe mendjes përfaqësojnë komponentë të rëndësishëm të shëndetit mendor, të cilët kontribuojnë, në shkallë të ndryshme, në gjendjen e ekuilibrit të brendshëm. (Sipas Galderisi et al. 2015).

Nga ky përkufizim i shëndetit mendor, i këtyre autorëve, mund të nxjerrim në pah disa elemente që ndërlidhen me dhunën ndaj fëmijëve dhe ndikimin në prishjen e ekuilibrit të brendshëm të individit. Nuk mund të flasim për një ekuilibrim të brendshëm të fëmijës, ose të bashkë ndiejmë me të tjerët nëse ai/ajo kanë qenë viktimë e dhunës, cilëndo qoftë. Nëse kihet parasysh edhe mosha e tyre mjaft delikate, vështirë se mund ta përballojnë ngjarjen negative siç është dhuna, sidomos ajo fizike. Gjithashtu, cilado qoftë dhuna e ushtruar ndaj një krijese në zhvillim, patjetër që do ta prishë harmoninë ndërmjet mendjes dhe trupit, prishje e këtij ekuilibri. Nga prishja e këtij ekuilibri nuk mund të presim angazhim në mësim, siç e kanë cekur shumë nxënës për rastet që ata i njihnin.

Gjetjet e hulumtimit, sidomos pasojat dhe shkaqet e dhunës në familje, të identifikuar nga ana e nxënësve, janë thuajse në përputhje të plotë me gjetjet shkencore të autorëve të ndryshëm. Keqpërdormi dhe abuzimi me alkool dhe gjendja e vështirë sociale e prindërve, në këtë rast e babit, paraqitet në shumë raste nga fëmijët pjesëmarrës në studim.

Vitin e kaluar kam pasur një shqisje e cila ka qenë viktoria
 e dhunës në familje. Babai i saj përdorte alkool, ndërsa
 nëna e saj ishte gjithë ashtu e viktoria dhunë në familje.
 Shogja ime shpesh herë i shkonte në mendje ai mendim
 që ta parajgjente babain e saj në polici. Ajo ka pasur
 një ndryshim të madh në shkollë. Ajo fillon të mos
 merrte as më parë pjesë në punimet e saj u ndanë.
 Ajo nuk ishte e lejuan të jetonte me nënën e saj pjesërisht
 të kushtet financiare të nënës së saj (ky vendim ishte i
 gjykatës). Ajo ishte e lejuan të takonte nënën e saj vetëm
 dy herë në javë (E hënën, e dielën). Por pas një kohe babai
 i saj u martua me një grua tjetër. Ajo grua me të
 cilën babai i shqisje treme u martua jo ndryshe jetën
 babait të saj, sepse pas martesës së dytë babai i saj
 e ka alkoolin dhe nuk ishte më një njeri agresiv e
 i pag si më parë. Tani shogja ime jeton një jetë më
 të lumtur sepse gruas me të cilën babai i saj u martua
 ishte një grua e mirë e cila kujdeset për shogjen treme.
 Por megjëse se pas pas shogja ime ndjen mungesën e
 nënës. Por të gjithë nuk jeton më në dhunë.

Foto 3: Përshkrim i dhunës në familje, por edhe i ndjeshmërisë së problemit të dhunës nga fëmijët. Shembull i rrëfimit nga një nxënëse.

14.5. Shkaqet dhe pasojat e dhunës – konceptet kryesore

Duke qenë se të dhënat nga nxënësit janë grumbulluar përmes rrëfimeve dhe grupeve të fokusit, është me rëndësi paraqitja e koncepteve kryesore që burojnë prej tyre (Tabela 3). Këto koncepte paraqesin këndvështrimin e nxënësve dhe shërbejnë si pikënisje për studime të thelluara me mostër më

gjithëpërfshirësve, si në numër të nxënësve ashtu edhe në mbulim të komunave dhe shkollave përkatëse.

Tabela 3. Konceptet kryesore të shkaqeve dhe pasojave të dhunës sipas nxënësve.

Konceptet kryesore të shkaqeve të dhunës	Konceptet kryesore të pasojave të dhunës
<p>Mosbindja – kur prindi cakton rregulla brenda familjes dhe fëmija nuk i respekton aty mund të ketë edhe dhunë fizike edhe psikike. Qortohet fëmija, fyhet e ndonjëherë edhe rrihet.</p> <p>Mosrespektimi – dallimi ndërmjet bindjes dhe respektimit të një rregulle është se të bindesh d.m.th. të veprosh në atë mënyrë, ndërsa të respektosh d.m.th. të respektosh një mendim, por jo t’i bindesh atij mendimi.</p> <p>Xhelozia – tradhtia dhe problemet mendore, gjinia e fëmijës (nëse ka veç vajza), fëmijë me nevoja të veçanta, superioriteti i burrit.</p> <p>Bullizmi – problemet në familje, pamja fizike, personaliteti, depresioni, vetmia, mëson shumë, problemet mjekësore (astma).</p>	<p>Problemet psikike – si pasojë e dhunës emocionale dhe dhunës fizike, pranisë së dhunës. Shfaqja e ankthit, depresionit, stresit, pagjumësisë, mund të ketë nevojë për psikolog.</p> <p>Lëndimet fizike – ushtrohet dhunë fizike brutale ndaj fëmijëve, rrahje ndërmjet prindërve, rrahje e fëmijëve nga prindërit.</p> <p>Gjendja e rënduar emocionale, tentim (ose plan) për vetëvrasje, depresion, ankth, stres, frika se do të dhunohet përsëri.</p> <p>Si dëshmitarë të dhunës paraqesin shenja të bullizmit e stresit post-traumatik, lëndime të vetvetes, mbyllur në vete, distancim nga të tjerët, hakmarrje ndaj atyre që e bullizojnë.</p> <p>Debatet e forta në familje, problemet financiare, shëndeti</p>

<p>Ngacmimet – për shkak të pamjes fizike, bullizimi, problemet psikike dhe emocionale.</p> <p>Abuzimet – një shoqëri jo e mirë, rreth i papërshtatshëm, përdorimi i lëndëve narkotike, alkoolit, duhanit e drogave të tjera dhe mospërfillja e përgjegjësisë, biseda të ashpra me fëmijët, keqpërdorimi i mjeteve elektronike, suksesi i dobët në mësim dhe disrespekti ndaj prindërve.</p> <p>Problemet sociale – ekonomike, problemet sociale, problemet politike, depresioni, ankthi, rrethi shoqërorë, presioni.</p> <p>Lojërat e fatit – humbja e parave, përdorimi i lëndëve narkotike, depresioni në punë.</p> <p>Trauma – e përjetuar në fëmijëri, e shkaktuar nga keqpërdorimi me alkool, mbingarkesa e proceseve jetësore, analfabetizmi, ndikimi shkollor i dobët, mosedukimi njerëzor, xhelozia, pijet alkoolike, neglizhenca.</p> <p>Divorci – nga dhuna fizike, dhuna psikike, ndarja e familjes, mbidoza, dehja, agresiviteti, ngecja në zhvillim të fëmijëve,</p>	<p>mendor, shenja dhune, trauma dhe frika.</p> <p>Suksesi i ulët në mësim, lënia anash e aktiviteteve dhe mësimi, moskoncentrimi dhe heshtja në mësim dhe në shkollë, dëmtimi i marrëdhënieve me familjarët, keqpërdorimi me alkool.</p> <p>Varësi ndaj substancave narkotike, probleme shëndetësore, luhatje emocionale, arrogance, mospërqendrim, pasivitet e konflikt.</p> <p>Humbja e parave, dëmtim psikik i fëmijëve, traumatizim, humbja e vetëbesimit, ankthi dhe lodhja e tepërt.</p> <p>Divorci, ankthi, depresioni, mbyllja në vetvete, dëmtimi fizik, frika, depresioni.</p> <p>Mungesa e komunikimit, substancat narkotike, droga, alkooli etj.</p> <p>Vetëvrasja, nervozë, ulje e vetëbesimit, suksesi i dobët, depresioni, xhelozia, tradhtia, divorci i prindërve.</p> <p>Lëndët narkotike, gjendja ekonomike, varfëria, problemet në</p>
--	---

<p>stresi, problemet mentale, bullizimi, ankthi, varfëria.</p> <p>Sjellje asociale – nga problemet me nervozë, rrahje, probleme familjare, probleme martesore, probleme psikologjike, mosmarrëveshjet në shtëpi, konfliktet, dhuna fizike, dhuna psikike.</p> <p>Suksesi i ulët në mësim – i shkaktuar nga bërtitma e kërcënime në shtëpi nga prindërit, mosangazhimi në mësim e në shkollë.</p> <p>Mosedukata e prindërve – mungesa e shkollimit të prindërve, varësia nga duhani e alkooli, droga, problemet në punë, mosdëshira e të qenit prind, prindër adoleshentë.</p> <p>Përdorim i drogës dhe alkoolit nga prindi, dhuna që shkaktohet nga ai, nuk ishte vetvetja.</p> <p>Konfliktet dhe mosmarrëveshjet, keqpërdorimi i rrjeteve sociale, dhuna fizike, dhuna psikologjike, dhuna verbale.</p> <p>Mosrespekti ndaj personave në mosha të caktuara, mosbindja e</p>	<p>shkollë, stresi, dhuna fizike, dhuna psikike, vjedhja.</p> <p>Frika, humbje koncentrimi, stresi, urrejtje ndaj prindërve.</p> <p>Gjendja emocionale e fëmijës dhe gjendje e rënduar psikike, bëhet i dhunshëm dhe agresiv, ka probleme mendore dhe dëmtime trupore.</p> <p>Përdorimi i narkotikëve, vetëvrasja, depresioni, moskomunikimi, stresi, mungesat në shkollë, suksesi i dobët në mësim, agresiviteti, depresioni.</p> <p>Ankthi, stresi, pagjumësia, shenjat në trup, dhimbje koke, trauma, frikë, presion, dhunë, tentim për vetëvrasje, ankth, humbje interesi për aktivitetet shoqërore.</p> <p>Mosinteresimi për mësim, shpërqendrimi, lëndimet trupore, mosshprehja e lirë, mbyllje në vetvete.</p> <p>Lëndime trupore, dëmtim i shëndetit mendor, rikuperim i të moshuarve, moskomunikim i duhur.</p> <p>Mosardhja në shkollë, ankthi, stresi, depresioni, humbja e</p>
--	--

<p>personave të moshuar, moskujdesja e stafit institucional.</p> <p>Divorci i prindërve, dhuna verbale, dhuna fizike, presioni, jokomunikimi me prindër, dhuna familje, presioni për nota, pikëpamja e mësimit ndaj nxënësit.</p> <p>Thyerja e rregullave, mospajtimi, problemet financiare, mosrespektim, mendjemadhësia, edukimi, sjellja.</p> <p>Ndarja e prindërve, moslejimi i takimit të prindit tjetër, moskujdesja e prindërve ndaj fëmijës, divorci jo i rregullt (jo i barabartë) i prindërve (me probleme).</p> <p>Tradhtia, sëmundjet mendore, nervozë, mosmarrëveshje në familje, keqkuptime.</p> <p>Keqkuptime mes burrit e gruas, dhuna fizike, psikike e seksuale, përdorim të alkoolit, borxhe parash, sëmundje mendore, bullizimi.</p>	<p>motivimit, problemet financiare, raporti i keq me prindër.</p> <p>Pasoja fizike dhe mentale, frika, depresioni, vetmi, mosbesimi, keqtrajtimi, mosinformimi i duhur, ankthi.</p> <p>Vrasja, divorci, lëndimet trupore, shpërqendrimi në shkollë, përcjellja e përdorimit të dhunës, presioni, ankthi, nervozë/agresiviteti, depresioni.</p> <p>Lëndimet trupore, divorcet, frika, humbjet e koncentrimit, ankthi.</p> <p>Dhunë fizike, vetëvrasje, mosmarrëveshje në shoqëri, dhunë psikike, rënie në mësim, rënie në peshë, ankth, traumë, depresion, bullizëm.</p>
--	---

15. Përfundimet

Sipas gjetjeve të këtij hulumtimi, në Kosovë janë përligjur nja varg mekanizmesh për ndihmë viktimave të dhunës. Çështja e dhunës, nga cilado anë, ose ndaj çfarëdo lloj dhune, janë adresuar dhe janë përvijuar në dokumente zyrtare, duke u përligjur nga Kushtetuta e vendit deri te protokollet për evidentimin dhe raportimin e aktit të dhunës. Gjithashtu, analiza tregoi se janë ndërtuar mekanizma të shumtë për mbrojtjen e viktimave të dhunës, por jo edhe për parandalimin e dhunës në familje.

Mekanizmat për mbrojtjen nga dhuna, sidomos në familje, dëshmojnë me të dhëna numerike për sasinë e dhunës në familje. Të dhënat nga intervistat dhe raportet që siguroam flasin për raste të shumta dhe të llojllojta të dhunës në familje. Policia e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, Institucioni i Avokatit të Popullit, ofrojnë dëshmi të shumta për raste të dhunës në familje, si dhe për procedurat e ndjekur ndaj dhunuesve, si dhe viktimave të dhunës. Mirëpo, këta mekanizma nuk kanë, ose nuk na ofruan, dëshmi relevante për llojin e dhunës, si dhe për prezencën e fëmijëve në aktet e dhunës në familje, si vëzhgues ose pjesëmarrës pasivë, viktimë të dhunës së tërthortë, në ato akte. Mekanizmat e lartcekur merren me pasojat e dhunës në familje, sidomos me rehabilitimin, strehimin ose edhe ndjekjen e dhunuesve, si çështje humane dhe e së drejtës për jetë, por mandati i tyre nuk merret me parandalimin e akteve të dhunës. Ndjekja e aktorëve të dhunës dhe dënimi i tyre nuk parandalojnë ose eliminojnë dhunën në familje. Rehabilitimi i viktimës, si objekt i dhunës, zakonisht del të jetë gruaja, ndërsa dhunuesi burri. Por, çfarë ndodh me rehabilitimin e fëmijëve, të cilët e kanë përjetuar dhunën në formë të tërthortë? Për këtë nuk ka të dhëna të mjaftueshme, përjashtuar disa raste të shmangies së fëmijëve nga familjet me probleme sociale dhe mendore.

Nga hulumtimi i udhëhequr nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK, 2015) gjetëm të dhëna me interes për argumentimin e tezës sonë, se pasojat e dhunës në familje për fëmijët janë të pariparueshme. Nga ky hulumtim del se te ne ekziston njëfarë “tradite” ose miratim i ushtrimit të dhunës si ndaj

gruas, ashtu edhe ndaj fëmijës. Sipas studimit, thuhet se burri ka të drejtë nganjëherë ta rrahë gruan, ose e arsyeton rastin kur babai përdor shuplakën ndaj fëmijës. Kjo “e drejtë” në njëfarë mënyre konfirmohet edhe nga nxënësit pjesëmarrës në studim, të cilët në disa raste theksuan se ”fëmija duhet t’i bindet prindit” kur ai i qorton ose kërkon diçka prej tij (RrGK, 2015).

Nga analiza e rrëfimeve të nxënësve vihen në spikamë dukuria e dhunës, gjendja emocionale dhe përjetimet e tyre në raste të këtilla. Nxënësit, shumica syresh, kanë rrëfyer përvojat e të tjerëve, në raste edhe përvojat personale. Në shumicën e rasteve të cekura, të përshkruara nga nxënësit e klasave të ndryshme dhe rajoneve të ndryshme, babai është ai që ka shkaktuar dhunë në familje, ndaj gruas në rend të parë, pastaj edhe ndaj fëmijëve. Në këto raste, është mjaft domethënës përshkrimi i përjetimeve dhe gjendjes emocionale të “viktims” pas përjetimit të dhunës, qoftë si objekt apo si vëzhgues i saj në familje. Zakonisht, gjendja shpirtërore dhe emocionale e tyre përshkruhet si humbje e interesimit për mësim, rënie në sukses, izolim nga shokët/qet, humbje e vetëbesimit, shfaqje e agresivitetit etj.

Gjithashtu, nxënësit, pjesëmarrës në mostër, i kanë identifikuar shkaqet apo rrënjët e prezencës së dhunës në familje. Shumica i kanë identifikuar si burime/shkaqe të dhunës në familje këta faktorë: çështjet socio-ekonomike, alkoolizmin, mungesën e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes e bashkëshortëve në veçanti, nivelin e ulët të edukimit në familje, suksesin/notat jo të mira në shkollë, sjelljen jo të mirë të fëmijëve në shtëpi, divorcin etj.

Pasojat për fëmijët nga dhuna në familje janë të rënda, të paevitueshme. Nxënësit i kanë evidentuar pasojat kryesore, domethënëse për fëmijët, si: humbja e vetëbesimit, agresiviteti, depresioni, mbyllja në vete, rënia e suksesit në mësim, humbja e disponimit dhe mbyllja në vetvete, ndjenja e frikës se dhuna mund të përsëritet, konfliktet me të tjerët, ikja nga orët e mësimit dhe nga shtëpia, rritja e shkallës së agresivitetit, stigmatizimi nga të

tjerët. Të gjitha këto shkaktojnë prishjen e balancës së shëndetit mendor dhe fizik të fëmijëve.

Në fund të rrëfimeve, nxënësit në disa raste kanë dhënë edhe porosi konkrete për parandalimin e dhunës. Kjo formë e të shprehurit paraqet thirrje për ndihmë dhe kërkesë për mbështetje, për faktin se pasojat nga ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve në familje janë të pranishme në masë të madhe. Mesazhet e tyre janë alarm për spektrin e gjerë shoqëror dhe atë institucional, për të ndërmarrë hapa për parandalimin e dhunës dhe për të bërë prioritet në nivel të politikave dhe veprimeve institucionale, në nivel qendror dhe lokal.

16. Rekomandimet

Të dhënat statistike, por edhe ato të raportuara në media, tregojnë se dhuna në familje është e pranishme. Fëmijët janë ose objekt i drejtpërdrejtë i dhunës ose pjesë/element “vëzhgues” i saj, në forma të ndryshme. Duke pasur parasysh pasojat e evidentuara nga ky hulumtim, sugjerohen rekomandimet në vijim.

- ❖ Kërkohej të bëhet një ndërgjegjësim dhe mobilizim në nivel vendi për ndërtimin dhe funksionalizimin e mekanizmave për parandalimin e dhunës në familje;
- ❖ Institucioni i munguar, i përgatitjes së të rinjve për krijimin e familjes dhe këshillimoret e ndryshme, do të ishte mekanizmi më i rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje;
- ❖ Puna psikosociale dhe pedagogjike me prindër është tejet e domosdoshme, sidomos me të rinjtë para dhe gjatë martesës së hershme. Rastet e rrëfyera nga nxënësit tregojnë për mungesë totale të përgatitjes pedagogjike të prindërve. Dhuna fizike ose verbale ndodh në prezencën e fëmijëve, të cilët e përjetojnë rëndë këtë akt të shëmtuar;

- ❖ Duhet fuqizuar bashkëpunimi shkollë-prindër, jo vetëm për raportin nxënës-shkollë- prind, por edhe rolin e shkollës në promovim të ndryshimit pozitiv në familje në raport me dhunën dhe edukimin e fëmijëve sidomos;
- ❖ Mediet, sidomos ata pamore, të luajnë një rol të fuqishëm në parandalimin e çfarëdo lloji të dhunës në familje;
- ❖ Institucionet shkencore dhe publike duhet të investojnë më shumë në promovimin e emisioneve të tilla që promovojnë jo dhunën në familje, që adresojnë pasojat e dhunës etj.;
- ❖ Shoqëria civile të kontribuojë në mënyrë pro aktive dhe të promovojë më shumë parandalimin e dhunës sesa të fokusohen në trajtimin e pasojave të saj;
- ❖ Institucionet e linjës: Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Shëndetësisë etj., duhet të hartojnë dhe të iniciojnë programe që inkurajojnë parandalimin e dhunës, por edhe që zgjidhin problemet socio-ekonomike dhe të komunikimit të mirëfilltë në familje;
- ❖ Aktivitetet e organizuara me fëmijë/nxënës, nga OJQ, shkolla etj., duhet të definojnë qartë konceptin e dhunës, si dhe pasojat e saj për nxënësit dhe shoqërinë në përgjithësi;
- ❖ Temat dhe përmbajtjet e ndërlidhura me format praktike dhe të efektshme të parandalimit të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj fëmijëve, në veçanti, të përfshihen në programe dhe materiale mësimore.

17. Kufizimet e hulumtimit

Hulumtimi i ka kufizimet, si: pamundësia për t'i përfshirë në mostër më shumë pjesëmarrës, sidomos ata që kanë qenë objekt i dhunës ose që kanë ushtruar dhunë ndaj të tjerëve. Gjithashtu, rezultatet e hulumtimit, të bazuara kryesisht në rrëfimet e nxënësve, nuk mund të përgjithësohen dhe të vlejné edhe për vendet e tjera.

Sugjerojmë që në të ardhmen të studiohet mostra e përbërë vetëm me nxënës, të cilët kanë qenë objekt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhunës në familje.

18. Burimet

- Agjencia për Barazi Gjinore. (2013). Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, Prishtinë.
<https://abgj.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20të%20Veprimit%20për%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20në%20Familje.pdf>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2014). Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) për Kosovë 2013-2014, Prishtinë.
- Balili, A. M. (2006). E drejta familjare, Tiranë.
- Creswell, J. W. (2007). Qualitative inquiry and research design: Choosing among five approaches (2nd ed.). Sage Publications, Inc.
- Deva-Zuna, A. (2008). Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike, Libri shkollor, Prishtinë.
- Elliott, J. (2005). Using Narrative in Social Research, Qualitative and Quantitative Approaches, SAGE, London etj.
- Farnsworth, N., Qosaj- Mustafa, A., Banjska, I., Berisha & Morina, D. (2015). Mjaft më me arsytetime, analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë: Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Prishtinë.
www.womensnetwork.org
- Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (FGJSSH). Version Elektronik, QEP.
- Galderisi S., Heinz A., Kastrup M., Beezhold J., Sartorius N. (2015). Toward a new definition of mental health. World Psychiatry, 14:231–233. doi: 10.1002/wps.20231.

- Grillo, K. (2002). Fjalor edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji), ISP, Tiranë.
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike. (2023). Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje Korrik 2022 – Qershor 2023. GLPS, Prishtina.
- Hillis, S., Mercy, J., Amobi, A., & Kress, H. (2016). Global prevalence of past-year Violence Against Children: A Systematic Review and Minimum Estimates. *Pediatrics*, 137(3).
- Institucioni i Avokatit të Popullit (2016). Opinioni i Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhet ndërmarrë institucionet përgjegjëse, nr. 1064/2016, datë, 15 nëntor 2016.
- Kaspiew, R., Horsfall, B., Qu, L., Nicholson, J. M., Humphreys, C., Diemer, K., ... Dunstan, J. (2017). Domestic and family violence and parenting: Mixed method insights into impact and support needs: Final report (ANROWS Horizons 04/2017). Sydney: ANROWS.
- Krasniqi, I. & Deva-Zuna. (2012). Një shkollë pa dhunë (Si ta bëjmë?), Libri shkollor, Prishtinë.
- Këshilli i Europës. (2011). Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. <https://rm.coe.int/168046246b>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2019). LIGJI NR. 06/L-084 Për mbrojtjen e fëmijës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 14 / 17, Korrik 2019, Prishtinë
- Matthews, D.B. and Ross, L. (2010) *Research Methods: A Practical Guide for the Social Sciences*, Pearson Education, Essex England.

- Mazreku, M. (2012). Dhuna ndërmjet nxënësve dhe topologjia e saj: Dhuna ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme të të dy niveleve në Kosovë. Prishtinë: Berati.
- Mekolli, S. (2015). Dhuna dhe siguria në shkolla. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). Strategjia e Arsimit 2022 – 2026. MASHTI. Prishtinë. <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Alb-Web.pdf>
- Ministria e Drejtësisë (2022). Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2022-2026. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombëtare-për-Mbrojtje-nga-Dhuna-në-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022—2026.pdf>
- Ministria e Shëndetësisë (2023). Udhëzimi Administrativ Nr. 04-2023 për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik të Fëmijës – Viktimë e Abuzimit për t'i ndihmuar në Rehabilitim dhe për t'u ri Integruar në Shoqëri. <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Udhëz55426924.9277.pdf>
- Nushi, P. (1987). Fjalori i psikologjisë, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Office of the Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children, (2020). Hidden scars: how violence harms the mental health of children, New York. https://violenceagainstchildren.un.org/sites/violenceagainstchildren.un.org/files/documents/publications/final_hidden_scars_lho_w_violence_harms_the_mental_health_of_children.pdf
- Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2020). Global status report on preventing violence against children. Geneva: World Health Organization; 2020. Licence: CC BY-NC-SA 3.0 IGO

<https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/332394/9789240004191-eng.pdf?sequence=1>

- Potera, I., Devetaku, H., Mehmeti, S., & Shala, L. (2012). Dhuna verbale ndaj nxënësve: Huluntim mbi fyerjet e nxënësve në shkollë. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
- Qeveria e Kosovës, (2013). Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës (2013). Rregullore QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar
- Rattanaavicha, P., Jutake, P., Piyapatkiti R. & Seetho, W., (2021). Family violence effect on mental health in the long run, GSJ: Volume 9, Issue 11, November 2021, Online: ISSN 2320-9186Đ, https://www.globalscientificjournal.com/researchpaper/Family_violence_effect_on_mental_health_in_the_long_run.pdf
- Royal College of Psychiatrists. (2015). Domestic violence and abuse: for parents and carers. <https://www.rcpsych.ac.uk/mental-health/parents-and-young-people/information-for-parents-and-carers/domestic-violence-and-abuse-for-parents>
- Sousa, C., Herrenkohl, T. I., Moylan, C. A., Tajima, E. A., Klika, J. B., Herrenkohl, R.C. Russo, M.J. (2011). Longitudinal Study on the Effects of Child Abuse and Children’s Exposure to Domestic Violence, Parent-Child Attachments, and Antisocial Behavior in Adolescence, J Interpers Violence. 2011 January; 26(1): 111–136. doi:10.1177/0886260510362883.
- UNDP (PVB) (Protokoll i ...) Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje ”T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” financiar nga Qeveria e Suedisë.
- UNICEF (2014). Hidden in Plain Sight: A statistical analysis of violence against children.

<https://data.unicef.org/resources/hidden-in-plain-sight-a-statistical-analysis-of-violence-against-children/>

Zyra Kombëtare e Auditimit (2023). Raporti i Auditimit të Performancës: Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti_Auditimit_Dhunanefamilje-shqip.pdf

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

343.55-053.2


316.48:347.61-053.2

Potera, Ismet

Shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj nxënësve në familje / Ismet Potera ... [etj.]. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2023. - 94 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Buleshkaj, Osman 2. Morina, Bekim 3. Mekolli, Skender
4. Reçica-Havolli, Sahare 5. Shala, Luljeta

ISBN 978-9951-591-65-2



A child's smiling self-portrait was drawn as part of an art therapy session at Beautiful Gate, a centre for abused and abandoned children in Lower Crossroads, a neighbourhood of the city of Cape Town. © UNICEF/UNI45429/Pirozzi